



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:007991  
Datë: 28.03.2023  
Numri i dokumentit: 04131867

**PKR.nr.238/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**, sipas kryetares së trupit gjykues Nushe Kuka Mekaj me gjyqtarët profesionist, Murat Hulaj dhe Arben Mustafaj, anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtoren profesionale Elzana Kastrati, në çështjen penale kundër të akuzuarit H. K., për shkak të veprës penale të kryer në vazhdimësi *Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së*, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda nën shenjë PP/I.nr.301/16 dt.10.11.2017, e ndryshuar për herë të fundit me datë 27.02.2023, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor të përfunduar me datë 27.02.2023, në prezencë të të akuzuarit H. K. dhe mbrojtësit të tij av.G. K., e në mungesë të të dëmtuarës Komuna e Pejës dhe Prokurorit të Shtetit Ersan Qavolli, me datë 01.03.2023, ndërsa me datë 28.03.2023, përpiloj këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **H. K.**, nga i ati N. dhe e ëma F., e gjinisë Zh., i lindur me datë ..... në Pejë, ku dhe jeton në rr. ...., nr. 5, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer Fakultetin e Biznesit, punon në zyrën për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Pejës, shqiptar, shtetas i R. Kosovës. Ka qëndruar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 19.10.2016 e gjerë me datë 18.12.2016.

**Në bazë të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPPK-së,**

**LIROHET NGA AKUZA**

**Për shkak se:**

Nga data 14.07.2016 e në vazhdimësi gjerë me datën 18.10.2016, me qëllim që t'i shkaktoj dëm personit tjetër dhe atë Komunës së Pejës, si person zyrtar, duke shfrytëzuar detyrën zyrtare, i tejkalon kompetencat e tij, të përcaktuara në akt emërimin nr. 01-112-169 në formularin-PDP, në atë mënyrë që, pasi i akuzuari kishte qenë i punësuar në Komunën e Pejës si zyrtar për tatim, e më pas në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa nga e cila ishte suspenduar, për tu transferuar

përkohësisht në vendin e punës zyrtar i lartë për të drejtat e komuniteteve dhe integrim në kuadër të Komunës së Pejës duke filluar nga data 28.12.2015 e gjerë me datën 28.12.2016, me qëllim të shkaktimit të dëmit Komunës së Pejës, nga data 14.07.2016 e deri me datën 18.10.2016, duke qenë i pajisur me linkun e sistemit *Protax* si ish zyrtar i tatimit në pronë, të shkarkuar në USB, pasi i akuzuari kishte të instaluar programin *Free Keylogger Pro* në kompjuterin e tij zyrtar me numër serik KPjKKP1-382, të G.T. dhe M.L. arrin që kësaj t’ia marrë password dhe username të sistemit *Protax* të M.s dhe përmes shfletuesit “GoogleChrome” dhe “Internet Explorer” futet në programin *Pro Tax–Login* dhe *ProTax –Departamenti i Tatimit në Pronë* tek përdoruesi M..L., gjersa përmes programit *Tor Browser* fsheh IP adresën e tij dhe aktivitetin si përdorues, fillimisht shfrytëzon kompjuterin e zyrtarit G.T., i cili ka qenë në të njëjtën zyre me të dhe duke shfrytëzuar kompjuterin e tij zyrtar dhe laptopin e tij personal, përmes të cilëve hynë në sistemin *Protax* dhe nga përdoruesi M.L. , pa u bërë pagesat, shlyen obligimet tatimore të dëshmitarëve J.K., E.A., A.K., N.B., V.M., R.K., A.K. dhe V.B., ashtu që Komunës së Pejës i shkakton dëm në shumën prej 18,275.98€, e më pas përmes programit *CCleaner* fshinë historinë e fajllave të shfletuar.

-Me çka kishte për të kryer veprën penale në vazhdimësi *Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së*.

Shpenzimet procedurale bien barrë e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Pala e dëmtuar Komuna e Pejës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.

## **A r s y e t i m**

### Historiku i rastit

Me datë 10.11.2017, Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngrit aktakuzë nën shenjën nën shenjën PP.nr.301/2016, e ndryshuar për herë të fundit me datë 27.02.2023, ndaj të akuzuarit H. K., për shkak të veprës penale të kryer në vazhdimësi *Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1, lidhur me nenin 81 të KPRK-së*.

Me lëndën në fjalë nën shenjën PKR.nr.286/20, ka qenë e ngarkuar tani e ndjera Gjyqtarja Lumturije Muhaxheri, ndërsa me datë 30.04.2021, jam ngarkuar me këtë lëndë si gjyqtare e çështjes.

Me datë 03.01.2020, gjykata ka marrë aktgjykim ndaj të akuzuarit H. K., për shkak të veprës penale *Keqpërdorim i detyrës zyrtare nga neni 422 par.1 të KPRK-së*, dhe e ka gjykuar me dënim me prej 6 (gjashtë) muaj.

Me aktvendimin nën shenjën nën shenjën PAKR.nr.97/20, të datës 15.10.2020, Gjykata e Apelit të Kosovës, çështja penale ndaj të akuzuarit H. K., e ka kthyer në rigjykim.

Me datën 13.05.2022 Gjykata e titullit, sërish ka marrë aktgjykim dënues në raport me të akuzuarin, të cilin e ka shpallur fajtor, ashtu që ka bërë rikualifikimin e veprës penale nga *Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1, lidhur me nenin 81 të KPRK-së*, në veprën penale *Hyrja në sistemet kompjuterike nga neni 339 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së*, të cilit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti në të cilin i'a ka llogaritur dhe kohën e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak si dhe dënimin me gjobë në shumën prej 1000 euro, si dhe e ka obliguar në pagimin e shpenzimeve gjyqësore. Poashtu, është obliguar i akuzuari që të dëmtuarës, t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar shumë prej 18.275.98€.

Gjykata e Apelit, me Aktvendimin PAKR.nr.340/2022 të datës 13.05.2022, ka aprovuar si të bazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Pejë si dhe të mbrojtësit të akuzuarit H. K. av.G. K. ashtu që është anuluar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë PKR.nr.286/2020 të datës 13.05.2022, dhe çështja penale është kthyer në rivendosje.

Gjykata, pasi që ka pranuar lëndën, të njëjtën e ka caktuar dhe ka vazhduar me procedimin e çështjes, ashtu që ka vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës së Apelit në Prishtinë.

### Kompetenca

Sipas nenit 11, paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat Nr. 03/L-199, Gjykatat Themelore janë kompetente për t'i gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.

Bazuar në aktakuzën e ngritur vepra penale e pretenduar ka ndodhur në Komunën e Pejës dhe rrjedhimisht bie brenda juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore të Pejës, sipas nenit 29, paragrafi 1 i KPPRK-së. Ndërsa sipas nenit 22 par.1, nënpar.1.2, pika 1.2.74 të KPPRK-së, veprat penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtare, bien në juridiksionin e Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore. Prandaj, e tërë lënda është gjykuar nga Departamenti i Krimeve të Rënda.

### Çështja/ Problemi

Sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit, si çështje në këtë rast, përveç vërejtjeve tjera lidhur me leximin e provova dhe administrimin e tyre pasi që është ndryshuar kryetarja e trupit gjykues, si çështje thelbësore na paraqitet fakti deri në cilën periudhë kohore ka qenë i akuzuari në Drejtorinë për Tatim në Pronë, dhe kur ka kaluar në Drejtorinë për Kthim dhe Komunitete si zyrtar.

-A ka qenë i akuzuari i pajisur me linkun e sistemit Protax si ish zyrtar i tatimit në Pronë;

-A e ka shfrytëzuar programin Free Keyloger duke e shfrytëzuar kompjuterin e zyrtarit G.T. si dhe duke përdorur llaptopin e tij;

-Përmes këtyre kompjuterëve a ka hyrë në sistemin Protax, dhe nga përdoruesi M.L. a ka shlyer obligimet tatimore të dëshmitarëve J.K., E.A., A.K., N.B., V.M., R.K., A.K. dhe V.B.;

-Si përfundim, nga veprimet e lartcekura të të akuzuarit, a përmbushen elementet e veprës penale *Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1, lidhur me nenin 81 të KPRK-së.*

### Shqyrtimi gjyqësor

Gjykata duke vepruar sipas vërejtjeve të dhëna në vendimin e Gjykatës së Apelit, ka caktuar dhe mbajtur seancën e rishqyrtimit gjyqësor me datë 10.01.2023, ku gjithsej janë mbajtur 4 seanca, përkatësisht me datë 10.02.2023, 22.02.2023, 27.02.2023, ndërsa seanca e datës 29.12.2022, në mungesë të kushteve ligjore nuk është mbajtur.

### Publiciteti i shqyrtimit gjyqësor

Të gjitha seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë rast kanë qenë publike, duke ju referuar dispozitave të KPRK-së, konkretisht nenit 288.

### Fjala hyrëse

Prokurori i Shtetit Ersan Qavolli, në fjalën e tij hyrëse ka deklaruar se pas dëgjimit të dëshmitarëve, administrimit të provave materiale përkatësisht të raportit të ekspertizës të datës 27.05.2019, përgjigjes në pyetjet e gjykatës nga E.M. të datës 06.05.2019, aktvendimit për transferimin e të akuzuarit H., ekspertizës Financiare punuar nga eksperti U.S. të datës 13.09.2018, raportit të ekspertizës të datës 31.01.2017, raportit të ekspertizës të datës 25.11.2016 dhe 12.10.2016, CD e ekspertizave, aktvendimit për shfrytëzimin e pushimit vjetor për M.L. të datës 30.09.2016, do të vërtetohet se i njëjti me veprimet e tij ka realizuar figurën e veprës penale për të cilën është ngritur aktakuzë.

Mbrojtësi i të akuzuarit H. K., av.G. K., në fjalën e tij hyrëse ka thënë se mbetem pranë fjalës hyrëse të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 16.09.2021, në të cilën mes tjerash ka thënë se pafajësia e të akuzuarit K., do të vërtetohet pas dëgjimit të dëshmitarëve, administrimit të provave materiale, e veçanërisht dëgjimit të ekspertëve të TI.

I akuzuari H. K., e ka mbështetur në tërësi fjalën hyrëse të mbrojtësit të tij.

### Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor

Prokurori i Shtetit Ersan Qavolli, me parashtrësën e datës 16.01.2023, ka propozuar që në këtë çështje penale në cilësi të dëshmitarëve të ftohen dëshmitarët si në vijim: M.L. , G.T., F.M., M.M., A.K., E.K., E.A., N.B., V.B.

Ndërsa në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 10.02.2023, ka hequr dorë nga propozimi për dëgjimin e dëshmitarëve M.M. dhe N.B..

Në cilësi të provës janë administruar, provat e propozuara nga Prokuroria, sipas aktakuzës janë dëgjuar dëshmitarët, si vijon:

- A.K., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.01.2023;
- J.A., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.01.2023;
- B.G., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.01.2023;
- G.T., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.02.2023;
- E.A., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.02.2023;
- E.K., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.02.2023
- F.M., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.02.2023.

Deri sa deklaratat e dëshmitarëve si më poshtë, me propozimin e përbashkët të palëve janë lexuar:

- M.L., dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 22.10.2021;
- V.B., dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 29.10.2019;
- A.K., dhënë në shqyrtimet gjyqësore të dt. 20.02.2019 dhe 16.09.2021.

Provat materiale:

- Raporti fillestar i incidentit me numër 2016-DE-300 i datës 26.08.2016;
- Raporti i hetuesit policor F.J.;
- Raport njoftues i përpiluar nga Drejtori i Financave J.A. i datës 26.08.2016;
- Vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshme të sendeve të datës 23.09.2016;
- Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve të datës 22.09.2016;
- Raporti i ekspertizës të shtëpisë me numër KPjKKP1-312 i shfrytëzuara nga H. K.;
- Vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve të zyrtares M.L. me numër 2016- DE-300 të datës 17.10.2016;
- Aktvendimi për shfrytëzimin e pushimit vjetor të nëpunësit M.L. ;
- Vërtetimi i të punësuarit H. K. për transferim në vendin e punës i lëshuar nga Komuna e Pejës;
- Procesverbali mbi bastisjen e shtëpisë dhe zyrës së H.K. të datës 19.10.2016;
- Procesverbali mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve nga S.C.- zyrtar për Komunitet dhe Kthim në Komunën e Pejës;
- Vërtetim mbi konfiskimin te përkohshëm të sendeve të pandehurit H. K.;
- Raporti i Ekspertizës së Drejtorie së teknikes kriminalistike nr. 195-FVTI-2016CD-1);
- Raporti i Ekspertizës së Drejtorisë së teknikes kriminalistike nr. 191-FVTI-2016 (kopja fizike);
- Raporti i Ekspertizës se Drejtorisë së teknikes kriminalistike nr. 191-FVT-016(dëshmit-9CD);
- Dëshmi fizike (funksioni i programeve ne dëshminë 8.1 5 fleta);

- Raporti i Ekspertizës së Agjencionit Kosovë për Forenzikë nr. AKF-2016-0095(kopja fizike);
- Raporti i Ekspertizës së Agjencionit Kosovë për Forenzikë nr. AKF-2016-0095(CD-1);
- Raporti-lista e obliguesve tatimor që ju kanë shlyer borxhet dhe evidencat e hyrje daljeve në objektet e Komunës së Pejës për vitin 2016 për 3 persona (dëshmia në CD-1);
- Raporti-nga Departamenti i tatimit në pronë për Komunën e Pejës për pagesat e tatimit në pronë për vitin 2014, 2015 dhe 2016 dëshmia në CD-1);
- Raport i Raffaisen Bank për xhirollogarinë e të dyshuarit K. (dëshmia në CD-1);
- Raporti i Procredit Bank për xhirollogarinë e të dyshuarit K. (dëshmia në CD-1)- (gjithsej 18 CD);
- Raporti-faturat e tatimit në pronë dhe kartelat e tatimit për vitin 2017 për obliguesit tatimor që iu kanë shlyer borxhet nga i dyshuari K.;
- Raport i TEB bankës për xhirollogarinë e të dyshuarit K..9 (kopja fizike);
- Raporti i kompanisë Vala për thirrjet hyrëse dhe dalje;
- Raporti i kompanisë Ipko për thirrjet hyrëse dhe dalje;
- Dëshmia (CD-ja) mbi dëmin e shkaktuar buxhetit të Komunës dhe tatim paguesve të ndryshëm.
- Ekspertiza financiare e përpiluar nga eksperti financiar U.S. e datës 12.04.2018.
- Përgjigja në pyetjet e gjykatës nga E.M. dt. 06.05.2019.

Ndërsa me propozimin e mbrojtësit të të akuzuarit K., av. G. K., janë administruar provat si më poshtë:

- Akt – emërimi me numër të kontratës II-112-9771-192;
- Formulari-PDP, i përshkrimit të detyrave të punës.

#### Marrja në pyetje e të akuzuarit

I akuzuari H. K., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 22.02.2023, ka shfrytëzuar të drejtën e mbrojtjes në heshtje, duke shtuar se lidhur me këtë çështje është deklaruar disa herë dhe nuk ka asgjë për të shtuar.

Me datë 21.02.2022, 25.03.2022 si dhe me datë 30.03.2022, i akuzuari ka paraqitur mbrojtjen e tij, në lidhje me këtë rast me deklaram.

I akuzuari në mbrojtjen e tij dhënë në të gjitha fazat e procedurës përfshirë dhe shqyrtimin gjyqësor, ka deklaruar se ka punuar në Drejtoratin për Tatim në Pronë deri në fund të vitit 2009, si zyrtar i tatimit në pronë. Gjatë kësaj kohe sa ka qenë në pozitë të zyrtarit në Drejtorinë për Tatim në Pronë, ka thënë se ka ndjekur disa trajnime bazike, mirëpo për shkak se në atë kohe kishte filluar një hetim penal (*që nuk ka të bëjë me këtë çështje penale*), i është ndërruar vendi i punës, dhe si pasojë e kësaj nuk ka arritur të jetë pjesëmarrës në disa trajnime tjera.

Nga data 28.12.2015 është transferuar në Zyrën për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Pejës. Detyrë e tij ishte dalja në teren për verifikimin e të kthyerve nga shtetet tjera në Kosovë. Në këtë zyre ka qenë së bashku me dëshmitarin G.T., dhe me një person të quajtur Sh.. G.T. ka thënë se,

ka pasur kompjuter në të cilin kohë pas kohe se bashku me të, kanë shiquar filma dhe ndeshje sportive, përmes një USB e cila ka qenë të djalit të tij Sokol K..

Tutje, ka thënë se menjëherë pasi ka kaluar në këtë zyre ka marrë pushimin vjetor, përkatësisht në janar të vitit 2016, ndërsa në qershor të vitit 2016 është pajisur me kompjuter. Sa i përket njohurive lidhur me kompjuter, ai ka thënë se është njohës mesatar.

Dëshmitaren M.L. , ka thënë se e njeh vetëm si punëtore të Komunës. Ndërsa dëshmitarët A.K., R.K., A.K., N.B., V.M., V.B., J.K., si dhe B.G., ka pohuar se i njeh si qytetar të Pejës, mirëpo ka mohuar në mënyrë kategorike që përmes përdoruesit të M.L. , e cila ishte zyrtare për tatim në pronë në Komunën e Pejës, ka ndërhyrë në ndryshim apo fshirje të obligimeve tatimore të këtyre personave, me arsyetimin se nuk ka pasur kompjuter.

Lidhur me “Protax”, ai ka thënë se është website, i cili instalohet nga Departamenti për Tatim në Pronë, në kuadër të Ministrisë së Financave, dhe se ky website instalohet vetëm për zyrtarët që punojnë në këtë departament në kuadër të Komunës së Pejës. Ka mohuar që ky program të ketë qenë i instaluar në kompjuterin e tij, ndërsa për dëshmitarin G.T., me të cilin ka qenë në zyre, ka thënë se nuk është në dijeni nëse i njëjti ka pasur apo jo, këtë program në kompjuter. Ka shtuar se linkun e “Protax”, e ka pasur të ruajtur në word document, i cili sipas tij nuk ka qenë aktiv, dhe se këtë link e ka poseduar me kërkesën e drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, M. R., në mënyrë që ai të mos vije nga Prishtina, në raste të mos funksionimit të ndonjë kompjuteri.

Nuk ka qenë në njohuri për programin “Free Keylogger”. I njëjti ka thënë se Policia e Kosovës, i kanë sekuestruar kompjuterin nga zyra, një laptop HP i cili ka qenë i fëmijëve të tij, si dhe një CD.

Tutje, ka thënë se nuk ka qenë në njohuri për fajllat ekzekutiv <sup>1</sup> që janë hapur nga USB e konektuar në prova D#3, e riemëruar si prova E#5 (Laptop “HP”, model HP ProBook 4720s).

Sa i përket faqes 25 të ekspertizës së datës 27.05.2019, ku janë paraqitur në mënyrë tabelare, shtegjet e vizituara nëpërmjet rrjetit kompjuterik nga prova E#2, në drejtim të kompjuterit i cili si përdorues ka M.L. <sup>2</sup>, i njëjti ka mohuar tek hyrë në të dhënat e kësaj dëshmitare.

<sup>1</sup> 1. F:\desk\keyloggerpro\_setup [1].exe; 2. C:\Users\Sokol Desktop\keyloggerpro\_setup [1].exe; 3. C5A40EF-A0FB-4BFC-874A 3 03 Oct 20 COF2E0B9FA8E}\Free Keylogger Pro Free KLP.exe. 4. F:\New folder keyloggerpro\_setup [1].exe).

<sup>2</sup> **1061.** <file:///10.153.68> 145/cs/Users/Makfirjete Limani/Desktop/shkronjat.doc-Haki Katallozi 07/20/2016 06:35:52 AM.

**1058.** fev/10.153.65.148/cs/Users/Makfirjete. Limani/Desktop/alpar.jpg-Haki Katallozi 07/18/2016 12:35:34 PM.

**1059** <file:///10.153.68> 145/CS/Users/Makfirjete.

Limani/fa77d2dees096b5a6be37d2bc1561d48.jpg -Haki Katallozi 07/18/2016 12:35:47 PM

**1070.** <file:///10.155.68.148/CS/Users/Makfirjete> Limani/tatimi.jpg 1070- Haki Katalozi 07/18/2016 12:35:51 PM **1071.** [file:///10.153.63.148/CS/Users/Makfirjete.](file:///10.153.63.148/CS/Users/Makfirjete)

[Limani/Pictures/Lyta/mm.jpg](file:///10.153.63.148/CS/Users/Makfirjete)- Haki Katalozi 07/18/2016 12:36:53PM

**1072.** [file:///10.153.68.148/CS/Users/Makfirjete.](file:///10.153.68.148/CS/Users/Makfirjete)

Limani/Pictures/kim20sybert/5\_1.JPG-Haki Katallozi 07/18/2016 12:37:02 PM.

Të akuzuarit gjatë mbrojtjes së tij, i janë parashtruar edhe disa pyetje në referim të gjetjeve të ekspertizës së punuar nga A.K. dhe Shqipe Salihu, të datës 27.05.2019, por i njëjti në vazhdimësi është përgjigjur se nuk e di, dhe nuk ka njohuri për gjetjet në këtë ekspertizë.

### Fjala përfundimtare

Me datë 27.02.2023, palët kanë paraqitur fjalën përfundimtare në formë të shkruar.

### Përmbajtja e fjalës përfundimtare

Prokurori i Shtetit Ersan Qavolli, në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar, ka deklaruar se është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Më tutje, në fjalën përfundimtare, prokurori i shtetit ka deklaruar se, për të vërtetuar se a kemi tejkallim të autorizimeve apo është përmbushur veprimi i kryerjes në formën tjetër, janë analizuar detyrat dhe përgjegjësitë e të akuzuarit, të cilat janë të lidhura me të drejtat e komuniteteve dhe për integrimin e tyre në kuadër të Komunës së Pejës, prandaj i akuzuari në vend se t'i kryente detyrat e tij ai i ka tejkalluar ato, pra i njëjti në cilësinë e personit zyrtar ka ndër marrë veprime të cilat janë në kompetencë të një personi tjetër zyrtar dhe si rezultat i këtyre veprimeve ka shkaktuar dëm Komunës së Pejës.

Prokurori në fjalën e tij përfundimtare po ashtu ka cekur se është shumë i vetëdijshëm se mbrojtja do të thirret se në rastin konkret nuk e kishte asnjë përgjegjësi për tatim i akuzuari H., mirëpo pikërisht në këto rrethana vije në shprehje tejkallimi i detyrave të tij. I akuzuari ishte i punësuar në Komunën e Pejës. I akuzuari duke qenë person zyrtar në këtë komunë ka pas qasje në sistemin Protax. Duke qenë zyrtar në këtë komunë, përmes kompjuterit zyrtar ka arrit të futet në kompjuterët e zyrtarëve G.T. dhe M.L. e cila është zyrtare e tatimit në pronë. I akuzuari përmes këtyre veprimeve, gjatë detyrës zyrtare i ka shlyer obligimet tatimore në mënyrë të kundërligjshme personave të përshkruar si më lart, të cilët atë kohë nuk i kishin paguar ato. Si pasojë e veprimeve të akuzuarit Komunës së Pejës, aty ku ishte i punësuar i akuzuari, i është shkaktuar dëm në vlerë prej 18,275.98€.

---

1073.

[file:///10.155.68.148/cs/Users/Makfirjete.Limani/Documents/fotofi20kompeticion/maki/phot\\_096201.jpg](file:///10.155.68.148/cs/Users/Makfirjete.Limani/Documents/fotofi20kompeticion/maki/phot_096201.jpg)-Haki Katallozi 07/18/2016 12:37:31 PM

1075. <file:///10.153.68.148/cs/Users/Makfirjete.Limani/Documents/Maki/1.jpg>-1075. Haki Katallozi 07/19/2016 07:09:57 AM

1076. <file:///10.153.68.148/cs/users/Makfirjete.Limani/Documents/tatim9520prone/report9620> (21) cav- Haki Katalozi 07/19/2016 07:15:11 AM



Në vijim ka shtuar se pas administrimit të provave materiale dhe personale (*të elaboruara më gjerësisht në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar*), pyetja e cila shtrohet është se a do të ishte mundur që i akuzuari t'i ndërmerre veprimet e përshkruara si më lart, sikur të mos ishte punësuar si zyrtar në të dëmtuarën Komuna e Pejës? Përgjigja është asesi JO! *Veprimi i kryerjes së kësaj veprë penale është përcaktuar në mënyrë alternative dhe atë në tri forma: shfrytëzimi i pozitës zyrtare (shpërdorim) apo autorizimeve, tejkalimi i autorizimeve zyrtare dhe mospërmëshja e detyrave zyrtare (moskryerja e detyrimeve zyrtare)*. Që në rastin konkret kemi të bëjmë me të dytën tejkalimi i autorizimeve zyrtare. Tejkalimi i autorizimeve zyrtare ekziston kur personi zyrtar vepron jashtë autorizimeve zyrtare dhe jashtë kompetencave të tij reale. Kryesi i veprës penale tejkalon kufijtë e autorizimeve të veta zyrtare, ngase ndërmerr veprime zyrtare të cilat janë në kompetencë të një personi tjetër zyrtar (të një instance më të lartë; a më të ulët), ose që i përket një shërbimi krejtësisht tjetër (shih komentarin e KPRK, faqe 1210). Që në rastin konkret i akuzuari H. K. ka tejkaluar kufijtë e autorizimeve të veta zyrtare në Komunën e Pejës, sepse ka ndërmarr veprime zyrtare të cilat janë në kompetencë të një personi zyrtar/shërbimi tjetër të Komunës së Pejës me të cilat veprime i ka shkaktuar dëm kësaj komune. Andaj, nga të lartcekurat mbetem në tërësi pranë aktakuzës, të përshkruar si në fillim të kësaj fjale përfundimtare dhe i propozoj Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor duke i shqiptuar dënimin e merituar. Me rastin e matjes së dënimit Gjykatës i ka propozuar që si rrethana rënduese konform nenit 70 të KPRK-së të marrë për bazë shkallën e lart të dashjes nga ana e të akuzuarit, mënyrën e kryerjes së veprës penale, përkatësisht dëmin e shkaktuar nga vepra penale, dhe sjelljen e të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor, përkatësisht me datën 25.03.2022 të akuzuarit i është tërhequr vërejtja që të mos përgjigjet derisa të mos shënohet dhe vlerësohet pyetja nga ana e gjykatës. Po ashtu me datën 22.10.2021 i është tërhequr vërejtja për ndërhyrje në përgjigjen e dëshmitarit G.T..

Bazuar në të lartcekurat i ka propozuar gjykatës, që ndaj të akuzuarit K., të merret aktgjykim dënues, pasi që është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se në veprimet e tij qëndrojnë elementet e veprës penale të përshkruara si më lart. Poashtu ka propozuar që ndaj të njëjtit të shqiptohet dënimi plotësues konform nenit 64 të KPRK-së, përkatësisht urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit dhe në kuptim të nenit 65 të KPRK-së, si dhe ndalimi i ushtrimeve të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik.

Në fjalën përfundimtare të mbrojtësit të të akuzuarit H. K., av.G. K., të dorëzuar në formë të shkruar mes tjerash ka thënë se aktakuza ndaj të akuzuarit K., ka qenë konfuze dhe e pambështetur në prova materiale. I akuzuari H., në kohën kur pretendohet se është kryer vepra penale e keqpërdorimit apo autoritetit zyrtar, me pozitë ka qenë si Zyrtar për Komunitet dhe Kthim në Komunën e Pejës, e që pozita e tij zyrtare dhe autoriteti zyrtar i të të akuzuarit, nuk kanë të bëjnë fare me punët dhe detyrat që kanë të bëjnë me zyrtarët e drejtorisë për tatimet në pronë.

Me tutje në fjalën përfundimtare mbrojtësi i të akuzuarit ka deklaruar se sipas përshkrimit të dispozitivit të aktakuzës i mbrojturi i tij ka arritur që përmes programit “Free Key Logger”,

program që shërben për vjedhjen e fjalëkalimit të shfrytëzuesit të kompjuterit të M.L. t, e që më pastaj nga kompjuteri i tij u fut përmes programit “Protax”, program i tatimit në pronë, futet në sistemin kompjuterik të zyrtares M., dhe në këtë mënyrë arrin të shlyej obligimet tatimore të dëshmitarëve.

Në lidhje me këtë program që është gjetur në kompjuterin e M.s, ajo gjithmonë ka deklaruar se nuk e din se çka është ky program, për çka shërben dhe aq më tepër që ta ketë instaluar të njëjtin, mirëpo duke u bazuar në deklaratën e ekspertit të IT-së, A.K., i cili ka deklaruar se ky program instalohet drejtpërdrejtë në kompjuter, pra fizikisht duhet të jetë para kompjuterit, atëherë shtrohet pyetja “*kush ia paska instaluar këtë program M.e cila punon në zyrë?*”, e që me siguri nuk është i akuzuari H., sepse asnjëherë nuk ka shkuar në zyrën e M.siç ka deklaruar edhe ajo e për më tepër të dy kanë punuar në objekte të ndryshme. Kësaj duhet t’i shtojmë edhe faktin se ky program është instaluar dhe deinstaluar në kompjuterin e saj, dikush pra ka manipuluar me kompjuterin e saj, dhe kjo dëshkohet edhe me ekspertizë.

Më tej prokuroria në dispozitiv poashtu ka deklaruar se i pandehuri nga kompjuteri i tij e përmes programit “Protax” është futur në sistemin kompjuterik të M.dhe nga aty ka arritur të shlyej obligimet tatimore. Edhe kjo është e pamundshme ngase programi “Protax” nuk është program që mund të ndërhyhet me ndonjë program tjetër, por është program që përmes “Web Browser” bëhet qasja në web site të tatimit në pronë duke pasur username dhe web site. Lidhur me këtë eksperti i IT-së A.K. ka deklaruar se nëse një kompjuter është ndalur nuk është e mundur ndërhyrja apo qasja në të. Do të thotë se në këtë periudhë kur pretendohet të jetë bërë qasja, M. ka qenë në pushim siç ka deklaruar edhe ajo. Vlen të cekët se sipas raportit për aktivitetet e programit “Protax” është gjetur se në këtë program në kompjuterin e M.s ka pasur ndërhyrje edhe me datat 15.04.2016 dhe 10.10.2016, në periudhë kur i akuzuari K., nuk ka pasur fare kompjuter, ngase i njëjti është pajisur me kompjuter ne fund të muajit maj të vitit 2016, pra kush paska bërë ndryshime dhe në muajin prill 2016. Se me të vërtetë i mbrojturi im nuk ka kryer veprën penale vërtetohet edhe nga përgjigjet që i kanë arritur gjykatës lidhur me pyetjet për qasjen në programin “Protax”. Edhe nga raporti i forenzikës ku përmendet “Protax” nuk ka asnjë veprim të qasjes në web site-in e protax, e sikur të kishte me pas veprime nga kompjuteri që e ka shfrytëzuar H., kishte me pas shenja nga historia e web browser të kompjuterit. Më tutje dhe dëshmitarët që janë dëgjuar e që janë të cekur në dispozitiv të aktakuzës, asnjëri prej tyre, siç kanë deklaruar edhe ata vet, nuk kanë qenë në dijeni të shlyerjes së këtyre tatimeve dhe se të akuzuarin e njohin vetëm si qytetar të Pejës.

Si përfundim ka propozuar që konform nenit 364 par.1, nënpar.1.3 të KPPRK-së, të merret aktgjykim lirues ndaj të akuzuarit K., ngase gjatë gjithë procedurës nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari H. K., e ka mbështetur në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Përfundimi i shqyrtimit gjyqësor

Me datë 27.02.2023 gjykata e ka shpallur të përfunduar shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penale.

### Shpallja publike e aktgjykimit

Me datë 01.03.2023, gjykata e ka shpallur publikisht aktgjykimin, në prezencën të të akuzuarit H. K., mbrojtësit të tij av.G. K., dhe pa prezencën e Prokurorit të Shtetit Ersan Qavolli, dhe të dëmtuarës Komuna e Pejës.

### Deklarimi i dëshmitarëve

Dëshmitari A.K., i dëgjuar në seancën e datës 10.01.2023, pasi më parë i është lexuar paralajmërimi nga neni 125 par.2 dhe 129 të KPP-së, ai ka deklaruar se kanë një biznes familjar që nga viti 2003 së bashku me vëllezërit e tij, dhe se e njeh të akuzuarin si një qytetar i Pejës, dhe se e ka ditur që ai punon në Komunën e Pejës, mirëpo nuk e ka ditur pozitën që ai e ka. Ka shtuar se gjithmonë i ka paguar obligimet tatimore, por jo të gjitha përnjëherë, por që në fund të vitit nuk ka pasur asnjë obligim. Nuk është në dijeni se dikush i'a ka shlyer obligimet tatimore. Sa i përket dëshmisë se pagesave, nuk e din nëse i ka të njëjtat.

I dëgjuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.01.2023, dëshmitari J.A., pasi më parë i është lexuar paralajmërimi nga neni 125 dhe 129 të KPP-së, mes tjerash ka deklaruar se të akuzuarin e njeh që nga viti 2014 kur ishte duke punuar si zyrtar në zyrën e prokurimit, në këtë periudhë ka qenë një hetim ndaj tij, dhe në mungesë provave nga ana e prokurorisë është hedh kallëzim penal, dhe kryetari i komunës e ka transferuar në zyrën për Komunitetet dhe Kthim diku ka mes i vitit 2015. Në zyrën për komunitete, i ka të përshkruara detyrat e punës me akt emërim, dhe kjo zyre nuk ka të bëjë me tatimin në pronë dhe as i akuzuari nuk ka pasë ndonjë kompetencë ligjërisht të lidhur me tatimin në pronë sa ka qenë në këtë zyre.

Më tutje ka shtuar se, sa ka qenë i akuzuari duke punuar në zyrën e tatimit në pronë, në vitin 2014 është zhvilluar një hetim për ndërhyrje në kartelat financiare dhe fshirjen e obligimeve tatimore, por që në mungesë të provave është ndërprerë ajo procedurë e në fakt kjo edhe ka qenë arsyeja se pse është zhvendosur në një objekt tjetër edhe fizikisht. Dëshmitari ka deklaruar se që të dy rastet, në vitin 2014 dhe 2016, që të dyja i ka iniciuar ai në hetuesi, lidhur me të akuzuarin, pas dyshimeve që ka parë në ndryshimet që kanë ndodhur në fshirjen e obligimeve tatimore, kur të hyrat që marrin nga BQK nuk janë përpatur. Personat për të cilët kanë dyshuar se u janë fshirë obligimet tatimore, janë A.K., B.G., ka mbiemër M. dhe M. por nuk i kujtoheshin mirë emrat, mund të ketë pas edhe mbiemër B.. Ka shpjeguar se sistemi Protax e ka bazën në Prishtinë, në Ministrinë e Financave, dhe se i akuzuari nuk ka pasur

qasje në këtë program ligjërisht, e as zyra lokale ku ka punuar i akuzuari nuk ka pasur qasje në Protax dhe nuk e kanë pasur të instaluar.

Pas arrestimit të të akuzuarit, ai tha se më nuk ka pasur ndërhyrje në sistemin Protax, por që përveç kompjuterit të të akuzuarit, është konfiskuar dhe një kompjuter i një kolegu të tij. Ka treguar se personat e vetëm të cilët kanë pas qasje me qëllim të ndërhyrjes në sistem, kanë qenë M., Y. dhe M..

Si përfundim, dhe një herë ka treguar se në kuadër të detyrave me të cilat punon i akuzuari që nga viti 2015 si zyrtar në zyrën e komitetit, nuk ndërlidhet me ndonjë detyrë zyrtare me departamentin e tatimit në pronë ligjrisht e as zyrtarisht.

I dëgjuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datën 10.01.2023, dëshmitari B.G. të cilit më parë i është lexuar paralajmërimi nga neni 125 dhe 129 të KPP-së, mes tjerash ka thënë, se të akuzuarin e njeh qysh para luftës, sepse kanë qenë ushtarë së bashku, se kanë lidhje shoqërore të mira, dhe se ka qenë në dijeni se i akuzuari ka punuar në kuvendin komunal për një kohë të gjatë, por që nuk e ka ditur pozitën e tij.

Obligimet tatimore për shtëpi dhe lokal tha se i ka 0 (zero) pasi i paguan gjithmonë. Në vitin 2016 e ka takuar të akuzuarin në komunë rastësisht, dhe e ka lutur që t'ia paguajë tatimin, duke i'a dhënë 180€ për pagesë, pasi që ka qenë tollovi dhe nuk ka mundur të presë. Ka thënë që i akuzuari i'a ka paguar tatimin, pasi që obligimin e ka pas zero, dhe për më tepër në zyrën e tij i akuzuari i'a ka lënë një pasqyrë tatimore, ku rezultonte se është paguar obligimi tatimor.

I dëgjuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.02.2023, dëshmitari G.T., të cilit më parë i është lexuar paralajmërimi nga neni 125 dhe 129 të KPP-së, ka deklaruar se ka dhënë edhe më herët deklarata lidhur me këtë çështje dhe se qëndron në tërësi pranë, duke shtuar se ende punon në Zyrën për Kthim dhe Komunitete.

Ai tha se edhe i akuzuari ka punuar në atë zyre së bashku me të, por që nuk i kanë pasur detyrat e njëjta. Zyra ku kanë punuar me zyrën për tatimin në pronë, nuk kanë asnjë lidhje në mes vete, pasi janë departamente të veçanta. Në zyre së bashku me ta, ka punuar dhe Sh. R.. Secili prej tyre ka pasur kompjuterin e vet, mirëpo i akuzuari kohë pas kohe e ka përdorur kompjuterin e tij por nuk e ka kuptuar se pse. Ka thënë se i akuzuari e ka ditur fjalëkalimin e kompjuterit të tij pasi që vet i'a ka treguar. Lidhur me zonjën M., ka deklaruar se të njëjtën e njeh sepse ajo punon në departamentin e financave, e i cili departament është i lidhur me departamentin e tatimit në pronë, kurse departamenti për kthim dhe komunitete është në një objekt tjetër me departamentet tjera të Komunës. Detyrat e të akuzuarit kur ka ardhur në këtë departament, ka pasur të bëjë vetëm me detyrat e departamentit për kthim dhe komunitete, dhe nuk ka pasur ndonjë detyrë që ndërlidhet në mënyrë të veçantë me tatimin në pronë. Ka shtuar se së bashku me të akuzuarin kanë dalur në teren të marrin informatat prej atyre familjeve të kthyera nga diaspora, ku kanë jetuar sa anëtarët të familjes janë dhe çfarë kushte ekonomike

kanë, në mënyrë që t'i ndihmojmë me ndihma apo ndërtim të shtëpisë, pra asgjë nuk ka pasur të bëjë me tatim në pronë.

I dëgjuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.02.2023, dëshmitari E.A., të cilit më parë i është lexuar paralajmërimi nga neni 125 dhe 129 të KPP-së, ka deklaruar se të akuzuarin e njeh në bazë të prindërve të tij dhe se nuk e di se çfarë ka punuar ai. Në vitin 2015 deri në 2017 ka thënë që e ka pas bashkëshorten të sëmurë me kancer dhe nuk e din nëse ka paguar apo jo tatim në këtë periudhë, sepse gjithmonë e paguan tatimi përmes bankës, por për shkak të kësaj situate, nuk i kujtohej. Më tutje ka shtuar, se tatimin ndonjëherë e ka paguar dhe përmes familjarëve të tij, varësisht nga situata. Kur ka dashur që të paguajë tatimin, ka shkuar në komunë, duke shtuar se aty punonin disa vajza, dhe se me të akuzuarin nuk është takuar aty sepse personalisht nuk e njeh.

I dëgjuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.02.2023, dëshmitari E.K., të cilit më parë i është lexuar paralajmërimi nga neni 125 dhe 129 të KPP-së, ka deklaruar se të akuzuarin e njeh si qytetar por që nuk ka ndonjë raport me të. Sa i përket vendit se ku ka punuar i akuzuari, ka shtuar se e din që ka punuar në komune por që nuk e din se çka. Lidhur me prona që ka në pronësi dhe pagesën e tatimeve lidhur me to, ka deklaruar se në pronësi ka një banesë në emrin e tij, kurse babai i tij një banesë dhe dy dyqane, dhe se tatimet i kanë paguar personalisht përmes bankës. Lidhur me vitin 2016 për pagesën e tatimeve, po ashtu ka deklaruar se i ka paguar personalisht përmes bankës, ku për vitin 2016, pagesa është bërë në fund të vitit, për dyqane ka qenë shuma 150 €, kurse për banesë 50€. Sa i përket çështjes se disa nga detyrimet shlyera janë të muajin e 7 dhe 8 të vitit 2016 J.K., si në vijim: 72.16 €, 524.18, 1.131.17, 153.71, 276.75, 232.30, 636.89 €, 323.82 dhe 281.72 €, ka thënë se nuk ka çfarë të thotë lidhur me këto shuma. Por më pas, ka deklaruar se nuk ka qenë në dijeni se janë fshirë shumat e përmendura, por se janë 4 vëllezër e ndonjëherë e paguajnë dhe vëllezërit. Lidhur me pagesat e bërë, të njëjtat i kemi ruajtur, por shtëpia ku kemi jetuar është rrënuar dhe tani nuk i kemi.

I dëgjuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.02.2023, dëshmitari F.M., të cilit më parë i është lexuar paralajmërimi nga neni 125 dhe 129 të KPP-së, ka deklaruar se të akuzuarin e njeh si qytetar dhe asgjë më shumë. Ka deklaruar se ka një shtëpi në emër të babait në fshatin Loxhë dhe një shtëpi me lokal në Pejë, ku pagesat i bënë vet e ndonjëherë edhe vëllau, kurse në vitin 2016 nuk e din se kush i ka bërë. Nuk i kujtohet në fakt nëse kanë barë pagesën për këtë vit, por thotë që me siguri që e kanë paguar. Periudhat se kur i paguajnë tatimet nuk i kanë të caktuara por kur të munden i kryejnë. Lidhur me tatimet e shlyera në emrin e babit të tij të bëra në muajin 8 dhe 9 të vitit 2016, nuk i kujtohet nëse i ka paguar në këtë periudhë.

I dëgjuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 16.09.2021, eksperti A.K., të cilit më parë i është lexuar paralajmërimi nga neni 125 dhe 129 të KPP-së, deklarata e të cilit është lexuar, mes tjerash ka thënë se me profesion është ekspert nga fusha e teknologjisë së informacionit në Policinë e Kosovës, pranë Drejtorisë së Teknikës së Kriminalistikës, i licencuar që nga viti 2014. Referuar kërkesës së gjykatës provat e dërguara për ekzaminim i kanë riemëruar si: E#1, E#2 dhe E#3 etj.

Pas ekzaminimit të dëshmitave lidhur me këtë rast, referuar raportit të datës 27.05.2019, kanë konstatuar se në provën e riemëruar si E#2, janë gjetur të dhëna për programin Free Keylogger,

30 fajlla, gjurmë për programet Pravysoft, dhe Team Viewer, kredencialet e përdorueses M.L. , se bashku me password<sup>3</sup>, programet CCleaner dhe TorBrowser, të cilat fshijnë gjurmët lidhur me aktivitetet që ushtrohen në atë kompjuter, si dhe fajlli në New Microsoft Office Word Document.docx, për adresën e programit Protax. Gjurmë të programeve Free Keylogger, Pravysoft, Ccleaner dhe TorBrowser janë gjetur dhe në provën E#5.

Tutje sipas ekspertit bazuar në ekzaminim të dëshmvive, ka rezultuar se prova E#2, me përdorues H..K., Administrator dhe kk-pe189, ka pasur qasje në drejtim të kompjuterëve përdorues e të cilëve kanë qenë M..L. dhe G.T..<sup>4</sup>

Për ta kuptuar më qartë tabelën e shfaqura në ekspertizën e datës 27.05.2019, eksperti i është referuar faqes 31 të ekspertizës, ku ka thënë se IP adresa me numër 10.153.68.148 me përdorues H..K., ka pasur qasje në kompjuterin tjetër me IP adrese 10.153.68.148 në volumin C, nën përdoruesin M.L. , në fajllin Protax-Login\_files me datë 21.07.2016 ora 11:27:45. Ndërsa në rreshtin 132, IP adrese 10.153.68.148 me përdorues H..K., ka pasur qasje në kompjuterin tjetër me IP adrese 10.153.68.148 në volumin C, nën përdoruesin M.L. , follderi arkiva.

Sa i përket programit Free Keylogger, ai tha se ky program ruan çdo të dhënë që shtypet në tastierën e përdoruesit të kompjuterit. Instalimi i tij mund të bëhet duke pasur qasje direkte në kompjuter, apo duke iu qasur nga distanca (qasje Remote). Ikona e programit Free Keylogger, nuk vërehet fare nga përdoruesi.

Ka theksuar se programi Free Keylogger, starton se bashku me sistemin operativ “Windows”, përveç nëse përdoruesi përzgjedh që të instalohet në mënyrë manuale. Sistemi operativ “Windows”, starton menjëherë pas shtypjes së butonit për ndezje, dhe nuk përfundon asnjëherë

deri sa është ndez kompjuteri. Ai konsiderohet se është aktiv, dhe mund të kesh qasje në të, ende pa e hap me fjalëkalim (pra pa u shfaqur ikonat).<sup>5</sup>

---

<sup>3</sup> Interpretimi i log-it. Me datë 07/21/2016 ora, 1:10:15 PM, në dritaren me titull “Protax-Login”, përmes shfletuesit “Googel Chrom”, nga përdoruesi “Makfirjete.Limani”, shkruhet e dhëna “mmeritamaki”. Faqe 19 nga 68 e ekspertizës.

<sup>4</sup> f.3.2 Nga rezultatet e nxjerra me programin Encase v8.05.00.182 rezulton se nga prova E#2 nëpërmjet rrjetit kompjuterik nga përdoruesit (user) Haki Katallozi, Administrator dhe kk-pe189 ka pas qasje në kompjuterë të ndryshëm. Listën e plotë e gjeni në pjesën Anexi\_1 -Tabela3.

Në mënyrë tablere-Tabela 2, paraqesim gjurmët (ang.log) e vizitave nëpërmjet rrjetit kompjuterik, nga prova E#2, nëpërmjet përdoruesit (user) Haki. Kartallozi, Administrator dhe kk-pe189 në drejtim të kompjuterëve të cilët identifikohen me përdoruesin Makfirjete.Limani dhe Gani.Toska.

Nga prova E#2, përdoruesi Haki. Katallozi ka pas qasje në kompjuterin që identifikohet me përdoruesin Makfirjete.Limani (referojuni rreshtave në tabelë 281-297, 301-334, 354-389, 397-439, 448-455, 471-479, 500-528, 553-558). Për më tepër shif ekspertizën e datës 27.05.2019, faqe 26 nga 28.

<sup>5</sup> Shih procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 16.09.2021, faqe 10 nga 13.

Tutje ka thënë se, për të siguruar username dhe password-in e një përdoruesi, nevojitet instalimi i një programi, i cili program (Free Keylogger) edhe është gjetur në provën E#2, dhe në momentin kur kuptohet passwordi, ai program nuk është më i nevojshëm. Referuar gjetjeve me rastin e ekzaminimit të dëshmitave, është gjetur se prova E#2 ka pasur qasje në provën E#3, pra qasje në këto të dhëna ka qenë sikurse E#2, të ishte pronar i tyre.

Sa i përket programit Free Keylogger, ai ka sqaruar se ky program regjistron të gjitha të dhënat që futen përmes njësive hyrëse tastierës dhe se në raste kur në kompjuter shkruhet password, në kompjuteri shfaqet si “xxx”, ndërsa tek kompjuteri tjetër që ka qasje në këtë kompjuter, këto “xxx” dalin shkronjat, numra, varësisht çfarë shkruan personi të cilit i është komprometuar siguria.

Eksperti ka thënë se në rastin konkret është komprometuar siguria e kompjuterit të dëshmitares M.L. , pasi që të gjitha të dhënat e saj kanë kaluar në provën E#2, për të sqaruar këtë rrethanë ai i është referuar faqes 17 nga 68 të ekspertizës, ku ka sqaruar se me datë 21.07.2016, në ora 1:10:15PM, është hapur dritarja e cila ka titullin Protax-Login, nëpërmjet shfletuesit Google Chrom, nga përdoruesja M.L. , dhe është shkruar e dhëna mmeritamaki.

E dëgjuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 22.10.2021, dëshmitarja M.L. , të cilës më parë i është lexuar paralajmërimi nga neni 125 dhe 129 të KPP-së deklarata e të cilës është lexuar, mes tjerash ka thënë se mbet pranë deklaratës së dhënë në shqyrtimin gjyqësor të mëparshëm me datë 17.01.2019, duke shtuar se punon si zyrtare për Tatim në Pronë në Komunën e Pejës, dhe se nga data 16.06.2016 deri me datë 24.06.2016, datë 07.07.2016, deri me datë 15.07.2016, si dhe nga data 16.08.2016 deri me datë 26.08.2016, ka qenë në pushim vjetor. Gjatë kësaj periudhe nuk ka shkuar asnjëherë në zyre, dhe se kompjuteri i saj ka qenë i kyçur. Në zyre ka punuar se bashku dhe me dy kolegë të tjerë.

Gjatë punës së saj, ka pasur në përdorim programin Protax, i cili shërben për futjen e të dhënave tatimore, dhe autorizim për përdorim të këtij programi ka pasur vetëm ajo dhe dy kolegët e saj në zyre.

Lidhur me të akuzuarin H. K., ajo ka thënë se në vitin 2012, ka qenë i punësuar në Departamentin për Tatim në Pronë, por për shkak dyshimeve ndaj tij, të njëjtin e kanë dërguar në Departamentin për Komunitete dhe Kthim.

Ndërsa në deklaratën e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mëparshëm me datë 17.01.2019, ka thënë se, kompjuterin e ka pasur në emër të saj dhe fjalëkalimin e ka ditur vetëm

ajo. Username i saj në programin Protax ka qenë M.L., kurse e-mail i saj në vitin 2016 si zyrtare dhe ajo private ka qenë “maki.L.” kurse passwordi njëherë e ka pasur “123456”, ndërsa më pas “merita maki” dhe këtë e ka përdorur në programin Protax. E-mailin privat e ka pasur [MakiL@hotmail.com](mailto:MakiL@hotmail.com). Të njëjtin e ka përdorur edhe si zyrtare, kurse passwordi fillimisht ka qenë “21.05.1966”, ndërsa më pas në kohën kur i është konfiskuar kompjuteri, passwordin e ka pasur

“@0105-210566”. Për username dhe password ka qenë në dijeni vetëm ajo. Programin “Free Keylogger” nuk e ka instaluar në kompjuterin e saj.

I dëgjuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 29.10.2019, dëshmitari V.B., deklarata e të cilit është lexuar, mes tjerash ka deklaruar se ka një biznes për shitje të mobileve që 17 vite, dhe obligimet tatimore i kryejnë kur vjen koha me i regjistru kamionët. Të akuzuarin e njeh si qytetar të Pejës, dhe nuk ka njohuri se ku punon e as që ka pas ndonjë kontakt me të ndonjëherë. Nuk ka njohuri që në kartelën financiare të tatimit në pronë me datën 14.09.2016 t’i jetë bërë ndonjë korrigjim dhe t’i është hequr ndonjë shumë e parave nga obligimi i tij tatimor, por ka shtuar se mund të ketë ndodhur që 5 herë në vit ka paguar tatim, për shkak të regjistrimit të kamionëve në periudha të ndryshme.

### Analizimi i provave materiale

Nga raporti fillestar i incidentit me numër 2016-DE-300 i datës 26.08.2016, vërtetohen veprimet e ndërmarra policore nga hetuesit policor.

Nga raport njoftues i përpiluar nga drejtori në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa J.A. i datës 26.08.2016, vërtetohet se rasti ishte paraqitur në NJHKE në Pejë, me dyshimin se ka eliminim të ngarkesës tatimore, për personat A., A., A.K., M.M., N.B., si dhe kanë qenë duke i hetuar dhe disa raste tjera.

Nga raporti i hetuesit policor F.J., i datës 29.08.2016, vërtetohet se është kërkuar autorizim me shkrim për veprime hetimore për rastin e paraqitur nga drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në kuadër të Komunës së Pejës, meqenëse ka pasur dyshim se është kryer vepra penale keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar nga ana e zyrtarëve komunal.

Nga vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshme të sendeve të dt.23.09.2016, vërtetohet se është konfiskuar përkohësisht shtëpiza e kompjuterit HP, me numër serik CZC4463WXZ, nga zyrtari F.K. nga Prishtina.

Nga vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve të datës 22.09.2016, vërtetohet se është konfiskuar përkohësisht një shtëpizë kompjuteri, pa emër, ngjyrë e zezë dhe numër serik me barkod KPjKKP1-382, nga këtu i akuzuari H. K..

Nga vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve me numër te rastit 2016-DE-300 dt.17.10.2016, vërtetohet se është konfiskuar shtëpiza e markës Hewlett Packard, ngjyrë e zezë, me numër serik CZC40731SG, me barkod nr. KPjKKP1-700, nga zyrtarja M.L. .

Nga aktvendimi për shfrytëzimin e pushimit vjetor të nëpunëses M.L. , vërtetohet se zyrtarja në fjalë ka shfrytëzuar pushimin vjetor në kohëzgjatje prej shtatë (7) ditësh, nga data 07.07.2016 deri me 15.07.2016.



Nga aktvendim i Komunës së Pejës i datës 24.12.2015 me numër 01-112-155786, vërtetohet se këtu i akuzuari K. është transferuar në vendin e punës si zyrtar i lartë për të drejtat e komuniteteve dhe integrim, në kuadër të Z.K.K.K, duke filluar nga data 28.12.2015 e gjerë me datë 28.12.2016.

Nga procesverbali mbi bastisjen të datës 19.10.2016, vërtetohet se zyrtarët policor kishin hyrë në bastisje në shtëpinë e të akuzuarit dhe Zyrën për Komunitete dhe Kthim, dhe gjatë bastisjes kanë konfiskuar një laptop i markës HP, me numër serik 2CE1240FJY, një hard disk Hitaxhi me numër serik S2TYVLYLE, një hard disk Maxtor, me numër serik E1LPSEEE, 3 CD. Ndërsa në zyrën për Komunitete dhe Kthim janë konfiskuar një telefon celular i tipit Samsung-Note 4, me sim karte me numër 049-350893, si dhe një telefon celular i tipit Samsung ShG 0880, me dy sim kartela 049237922 dhe 044574409, dhe një shtëpizë e kompjuterit Pentium 4 ngjyrë e zezë, me numër 238, barkodi KPjKKP13979, procesverbal i nënshkruar nga këtu i akuzuari H. K..

Nga vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve i nënshkruar nga S.C.-zyrtar për Komunitet dhe Kthim në Komunën e Pejës të datës 19.10.2016, vërtetohet se është konfiskuar përkohësisht shtëpiza e kompjuterit Pentium 4, ngjyrë e zezë me numër të barkodit KPjKKP1-379, e cila shtëpizë ka qenë në emër të zyrtarit G.T..

Nga vërtetim mbi konfiskimin të përkohshëm të sendeve të pandehurit H. K., vërtetohet se është konfiskuar një telefon celular i tipit Samsung-Note 4, me sim karte me numër 049-350893, si dhe një telefon celular i tipit Samsung ShG 0880, me dy sim kartela 049237922 dhe 044574409.

Nga raporti i Ekspertizës së Drejtorisë së teknikes kriminalistike numër 191-FVTI-2016 i datës 31.01.2017, vërtetohet se në provën D#1, rezulton të ketë aktivitet për softuerët e dyshimtë për vjedhje të të dhënave të kërkuar sipas Urdhëresës. Aktiviteti është zhvilluar me softuerët: Pravysoft, Free Keylogger Pro 9\_5\_2016, Free Keylogger Pro 7\_21\_2016, Free Keylogger Pro 3\_15\_2016, Free Keylogger Pro\_3\_11\_2016. Gjenden në fajllat e krijuar si: D1\_Raport\_EnCASE.pdf., RegistryReport.html;IEF\_Raport/index.html; Reg\_Ripper. Prova D#2 në këtë provë rezulton të ketë aktivitet për tentim të çasjes në Protax [http://10.41.0.74:59074/protax/login.jsp?login\\_error](http://10.41.0.74:59074/protax/login.jsp?login_error). Aktiviteti që është zhvilluar me softueret të tjerë si: Free Keylogger Pro\_9\_5\_2016, fk-logger dhe aktivitete tjera të dyshimta gjenden në fajllat:\EnCase\_Raport\D2\_Raport\_EnCase.pdf;\RegistryReport.html; \IEF\_Raport\index.html; \Reg\_Ripper.

Prova D#3 - Në këtë provë rezulton të ketë aktivitet për softuerët e dyshimtë dhe dokumente në lidhje me Komunën e Pejës të kërkuar sipas Urdhëresës. Të gjitha aktivitet me softuerët e dyshimtë dhe fajllat që kanë lidhje me Komunën e Pejës ndodhen në fajllat:\EnCase\_Raport\D3\_Raport\_EnCase.pdf;\EnCase\_Raport\D3\_Raport\_EnCase.html;Registry Report.html; \IEF\_Raport\index.html; \Reg\_Ripper.

Prova D#4-Të gjitha aktivitet ndodhen në fajllat:\EnCase\_Raport\D4\_Raport\_EnCase.pdf; Registry Report.html;\IEF\_Raport\index.html;\Reg\_Ripper. Të dhënat e ekstraktuara nga Telefonat, sim Kartelat dhe Kartelat Memoruese ndodhen në shtegun<sup>6</sup>.

Prova D#8.1 -Të dhënat (Softuerët) të cilat kanë qenë të vendosur në CD gjenden në shtegun: D8\D#8.1. Prova D#8.2-Të dhënat (Softuerët) të cilat kanë qenë të vendosur në CD gjenden në shtegun:\D8\D#8.2. Prova D#8.3-Nuk ka të dhëna që lidhen me rast. Të gjeturat janë dorëzuar në formë elektronike të vendosura në DVD me numër<sup>7</sup>.

Nga raporti i ekspertizës me numër 156-FVTI-2016 (folderi webpages-browser activity.html), rezultojnë shënimet e nxjerra me datë 22.09.2016 nga ora 08:05:45 deri ne 08:11:37, se ka pasur aktivitet në <http://10.41.0.74:59074/protax/taxpayer/searchTPS.jsf> qasje në programin e tatimit në pronë. Bazuar në dëshmitë e siguruara, evidencat elektronike të hyrjes dhe daljes së zyrtares M.L. , dëshmohet se e njëjta ka shtypur kartelën e hyrjes në komunë për datë 22.09.2016 në ora 08:07, kohë kjo kur veç ka filluar kyçja në “Protax” kurse H. K., dëshmohet se në ora 08:00, ka shtypur kartelën e hyrjes në punë.

Poashtu nga ekzaminimi i kompjuterit të M.L. , në internet Explorer 10-11 wekly history rezulton se me datë 22.09.2016, nga kompjuteri i M.L. , ka pasur dy qasje në programin e tatimit në pronë Protax, nga përdoruesi i saj dhe atë në ora 14:14:00 dhe në ora 14:56:58.

Bazuar në të dhënat e raportit të forenzikës numër 156-FVTI-2016 (internet Explorer Main History), të shtëpizës së kompjuterit H. K., rezulton se nga shtëpiza në fjalë të cilën e

ka shfrytëzuar i akuzuari përdoruesi (usseri) NTFS 224.51 gb H..K., i njëjti ka pasur qasje në mënyrë të paautorizuar në përdoruesin (usseri) e M..L., si në programin Protax, e poashtu edhe në dokumente të ndryshme të saj.

---

6

D#6.1\_Raport\_Samsung SM-N910cGalaxy Note4LTE(Untested)\index.html;  
D#6.2\_Raport\_SIMCard.pdf;  
D#6.3\_Raport\_Diskormemorycard\index.html;  
D#7.1\_Raport\_SamsungSGH-D880\index.html;  
D#7.1\_Raport\_SamsungSGH-D8801\index.html;  
D#7.2\_Raport\_SIMCard.pdf;  
D#7.3\_Raport\_SIMCard.pdf;  
D#7.4\_Raport\_Diskormemorycard\index.html;

<sup>7</sup> KL 30C6150916051950;

KL 30C4150916051948;

KL 30C6150916053031;

KL 30C1150916053535;

KL 30C4150916053547;

KL 30C1150916053540;

KL 30C4150916042421;

KL 30C5150916042417;

KL 30C4150916042407.

Shënimet e ruajtura mbi aktivitetet në internet main meny tregojnë aktivitete dhe qasje nga përdoruesi H. K., në adresat e M.L. .<sup>8</sup>

Bazuar në këto të dhëna në tabelle, i akuzuari përveç që ka ndërhyrë në adresën e M.L. , të tatimit në pronë, po ka pasur qasje edhe në dokumente, foto dhe të dhëna tjera personale të M.s në Hotmail dhe llogari tjera personale të saj.

Nga raporti i ekspertizës së Drejtorisë së Teknikës Kriminalistike nr. 191-FVT-016, rezulton se është ekzaminuar shtëpiza me numër serik CCZC40731SG, me barkod KPJKKP1-700 në emër të M.L. , ku sipas këtij raporti shtëpiza e saj ka pasur aktivitete me Keylogger. Aktiviteti është regjistruar me datë 11.03.2016 nga ora 12:01:19, datë 15.03.2016, ora 11:03:39, 16.03.2016 nga

8

1083/[file:///10.153.68.148/c\\$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/tatim%20prone/report%20\(18\).csv](file:///10.153.68.148/c$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/tatim%20prone/report%20(18).csv) Haki.Kartalozzi 07/19/2016 07:23:31 AM

1082

[file:///10.153.68.148/c\\$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/tatim%20prone/report%20\(19\).csv](file:///10.153.68.148/c$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/tatim%20prone/report%20(19).csv) Haki.Kartalozzi 07/19/2016 07:20:14 AM

1081

[file:///10.153.68.148/c\\$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/tatim%20prone/report%20\(18\).csv](file:///10.153.68.148/c$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/tatim%20prone/report%20(18).csv) Haki. Katalozzi 07/19/2016 07:20:34 AM

1080 [file:///10.153.68.148/c\\$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/tatim%20prone/report.csv](file:///10.153.68.148/c$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/tatim%20prone/report.csv) Haki.Kartalozzi 07/19/2016 07:16:52 AM

1079

[file:///10.153.68.148/c\\$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/tatim%20prone/report%20\(20\).csv](file:///10.153.68.148/c$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/tatim%20prone/report%20(20).csv) Haki.Kartalozzi 07/19/2016 07:16:57 AM

1078 [file:///10.153.68.148/c\\$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/tatim%20prone/report%20\(22\).csv](file:///10.153.68.148/c$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/tatim%20prone/report%20(22).csv) Haki Kartalozzi 07/19/2016

07:15:06 AM

1077

[file:///10.153.68.148/c\\$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/tatim%20prone/report%20\(1\).csv](file:///10.153.68.148/c$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/tatim%20prone/report%20(1).csv) Haki.Kartalozzi 07/19/2016 07:13:24 AM

1076 [file:///10.153.68.148/c\\$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/tatim%20prone/report%20\(21\).csv](file:///10.153.68.148/c$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/tatim%20prone/report%20(21).csv) Haki.Kartalozzi 07/19/2016 07:15:11 AM

1075 [file:///10.153.68.148/c\\$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/Maki/1.jpg](file:///10.153.68.148/c$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/Maki/1.jpg)

Haki.Kartalozzi 07/19/2016 07:09:57 AM

1073 [file:///10.153.68.148/c\\$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/foto%20kompeticio  
n/maki/photo%201.jpg](file:///10.153.68.148/c$/Users/Makfirjete.Limani/Documents/foto%20kompeticion/maki/photo%201.jpg) Haki.Kartalozzi 07/18/2016 12:37:31 PM

1072 [file:///10.153.68.148/c\\$/Users/Makfirjete.Limani/Pictures/kim%20sybert/\\$  
1.JPG](file:///10.153.68.148/c$/Users/Makfirjete.Limani/Pictures/kim%20sybert/$1.JPG) Haki.Kartalozzi 07/18/2016 12:37:02 PM

1071 [file:///10.153.68.148/c\\$/Users/Makfirjete.Limani/Pictures/Lyta/mm.jpg](file:///10.153.68.148/c$/Users/Makfirjete.Limani/Pictures/Lyta/mm.jpg)

Haki.Kartalozzi 07/18/2016 12:36:53 PM

1070 [file:///10.153.68.148/c\\$/Users/Makfirjete.Limani/tatimi.jpg](file:///10.153.68.148/c$/Users/Makfirjete.Limani/tatimi.jpg)

Haki.Kartalozzi 07/18/2016 12:35:51 PM

1069

[file:///10.153.68.148/c\\$/Users/Makfirjete.Limani/fd77d2dee8096b5a6be37d2bc1561d4  
8.jpg](file:///10.153.68.148/c$/Users/Makfirjete.Limani/fd77d2dee8096b5a6be37d2bc1561d48.jpg) Haki.Kartalozzi 07/18/2016 12:35:47 PM

1068 [file:///10.153.68.148/c\\$/Users/Makfirjete.Limani/Desktop/alpar.jpg](file:///10.153.68.148/c$/Users/Makfirjete.Limani/Desktop/alpar.jpg)

Haki.Kartalozzi 07/18/2016 12:35:34 PM

1061 [file:///10.153.68.148/c\\$/Users/Makfirjete.Limani/Desktop/shkronjat.doc](file:///10.153.68.148/c$/Users/Makfirjete.Limani/Desktop/shkronjat.doc)

Haki.Kartalozzi 07/20/2016 06:35:52 AM

ora 12:03:17, datë 22.07.2016, nga ora 12:01:08. Në raport të ekspertizës në Internet Explorer, 10-11, Dailz/Weekly History paraqiten aktivitetet e M.L. t, në shtëpizën e saj nga data 27.04.2016 e deri me 22.09.2016, kur dhe është konfiskuar shtëpiza e të akuzuarit. Në këtë raport janë paraqitur veprimet reale të qasjes në Protax, nga M.L. si dhe aktivitetet e Keylogger. Sipas raportit të ekspertizës të gjitha aktivitetet e zyrtares Makirjete janë të evidentuara në Internet Explorer 10-11, main menu të cilat shënime gjenden si dëshmi në CD raportin (webpages).

Nga raporti i ekspertizës 191-FVTI-2016, është ekzaminuar shtëpiza e markës “*Pentium 4 Dual Core*”, me barkod numër KPJKKPI-379, e zyrtarit G.T., në zyrën për Komunitete dhe Kthim në Pejë. Bazuar në të dhënat e ekspertizës të cilat gjenden si provë në CD, dëshkohet se i akuzuari H. K., i cili ka punuar në të njëjtën zyre me zyrtarin G.T., në periudha të ndryshme kohore është kyçur në mënyrë të paautorizuar në këtë kompjuter, e më pas në përdoruesin e M.L. . Bazuar në aktivitetet e regjistruar e të paraqitura si më poshtë dëshkohet se edhe në këtë shtëpizë të zyrtarit Gani (aktiviteti nën numrin rendor 106 në tabelle), i akuzuari kishte instaluar “Keylogger”, i cili ka pasur aktivitete me datë 16.09.2016 në ora 11:59:48, përmes drive\_removable, ashtu që përmes kësaj shtëpize ka nxjerrë të dhëna edhe për aktivitetet e G.T. e poashtu edhe të M.L. . Poashtu janë regjistruar aktivitete me datë 08.07.2016 (nga numri 36-49), në shtëpizën e Gani Toskës, përmes drive\_removable kingston, nga pra 12:22:387 deri në ora 10:22:42. Sipas raportit të ekspertizës në Internet Explorer main menu, dëshkohet se me datë 13.10.2016, në ora 11:39:33, ka pasur qasje në fajllin e cekur nga shtëpia e G.T. dhe me përdoruesin e tij. Me datë 01.03.2016, poashtu ka pasur qasje në këtë shtëpizë ku përmes përdoruesit GT-ZKKK, llogari kjo e krijuar në shtëpizën e Gani Toskës, është qasur në përdoruesin M.L. . Në internet Explorer Daily History, nga përdoruesi GT-ZKKK, janë regjistruar qasje dhe kërkime në përdoruesin e G.T. duke përdorur programin Pravy soft (Keylooger).

Poashtu në këtë shtëpizë janë regjistruar aktivitete përmes përdoruesit G.T. GT-ZKKK.KK-PE205, dhe si administrator ku i dyshuari përmes të gjitha këtyre llogarive ka zhvilluar dhe pasur qasje në aktivitetet të kundërligjshme, si instalim të programeve.

Bazuar në raportin e ekspertizës numër 191-FVTI-2016, prova D#3, është ekzaminuar laptopi i markës “HP” me numër serik 2CE1240FJY, model HP Probook 4720S, produkt XX863EA#ABB, ngjyrë e zezë, i cili është konfiskuar gjatë bastisjes në shtëpinë e të akuzuarit H. K.. Sipas raportit kjo pajisje identifikohet me emrin Sokol-PC, që korrespondon me emër të njëjtë me djalin e të akuzuarit H. K..

Kjo provë D#3, posedon material në 9 CD, të cilat janë ekzaminuar. Sipas raportit ka rezultuar të ketë aktivitet për software e dyshimtë dhe dokumente në lidhje me Komunën e Pejës, të kërkua sipas urdhëresës. Në raport dëshkohet se ekzistojnë 1010 dokumente brenda pajisjes që ndërlidhen me prokurim të komunës, si kontrata, dosje të tenderit, njoftime për dhënie të kontratës, vendime të vlerësimit dhe shkresa tjera me gjithsej 3217 dokumente që përfshinë periudhën e vitit 2012 dhe 2013, kohë kjo kur i akuzuari ka punuar në zyrën e prokurimit.

Në CD nga 3-1 deri në 3-8, gjenden dokumente të zyrës se prokurimit dhe dokumente e programe që janë hapur, si Tor Browser (dokumenti nr. 5176 dhe 5177), test-phish-simple.cache.test

malware simple.sbstore dhe programe tjera që janë hapur përmes programit Tor Browser që si qëllim kanë gjetjen e mënyrës së qasjes në rrjet dhe vjedhjen e të dhënave, programe këto të përdorura edhe në shtëpizën të cilën e ka përdorur i akuzuari në zyrën e tij për Komunitete dhe Kthim.

Bazuar në raportin e ekspertizës numër 191-FVTI-2016 (prova nr.4 sipas raportit), është ekzaminuar hard disku Hitaxhi me numër serik S2TYVYLE,P/N: 0A30210 kapacitet 80GB, i sekuestruar përkohësisht në shtëpitë e të akuzuarit H. K..

Sipas ekspertizës në këtë hard disk janë nxjerr 25 faqe me gjithsej 141 dokumente, në mesin e këtyre dokumenteve, ka dokumente të tatimit në pronë e dokumente tjera komunale, si dhe programe të cilat mundësojnë ndërhyrje në sistemet kompjuterike si IP të serverëve, team wiever. Sipas këtij raporti, ka pasur dokumente me emrin Suzana 2009, si dhe dokumente për licencat mars 2011, dokumente këto të cilat sipas informatave nga drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa J.A., është e autorizuar vetëm zyrtarja Suzana, e cila ka qenë e ngarkuar me licencat e bizneseve të cilat iu kanë mbetur borxh Komunës së Pejës.

Sipas raportit të ekspertizës nr. 191-FVTI-2016 (prova e evidentuar me numër 5), nuk ka qenë e mundur të ekzaminohet.

Bazuar në raportin e ekspertizës numër 191-FVTI-2016 (prova 6.6#1 sipas raportit), është ekzaminuar një telefon i markës Samsung Note 4, Samsung SM-N910C, model SMN910C, Imei355025/06/284159/6.S/N RF7FB01C6QF, ngjyrë e zezë. Sipas ekzaminimit janë gjetur foto të ndryshme personale, por edhe një foto personale e drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa J.A..

Bazuar në raportin e ekspertizës numër 191-FVTI-2016 (prova nr. 6#2 sipas raportit) është ekzaminuar sim kartela “Ipko, mirëpo nuk është gjetur ndonjë dëshmi relevante lidhur me këtë çështje.

Sipas raportit të ekspertizës numër 191-FVTI-2016 (prova nr. 6#3 sipas raportit), rezulton se është ekzaminuar disk memory card ku njëra ndër fotot është edhe e drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, J.A., ku shifet monitori “Philips”, për të cilit është fotografuar.

Bazuar në raportin e ekspertizës numër 191-FVTI-2016 (prova D#7.7.1, sipas raportit), është telefon Samsung SGHD880, model SGHD880, imei 354523/02/143213/6, imei 2: 354524/02/143213/4.S/N: R 9YQ633210Z, ngjyrë e zezë, sipas këtij ekzaminim nuk ka pasur të dhëna relevante.

Sipas raportit të ekspertizës numër 191-FVTI-2016 (prova D#7.7.3) sim kartela “Ipko”, rezulton se nuk ka pasur të dhëna relevante.

Sipas raportit të ekspertizës me numër 191-FVTI-2016 (prova D#7.7.4), micro sd “Nokia” 2gb, rezulton se janë gjetur foto personale dhe familjare të qytetarit S.Q., si dhe janë gjetur dy foto të dy armëve (pistoleta) me numër serik C-120335.

Bazuar në raportin e ekspertizës me numër AKF-2016-0095, rezulton se është bërë ekzaminimi i shtëpizës së kompjuterit të markës HP, me numër serik CZC4463WSY, e konfiskuar përkohësisht nga zyrtari i Departamentit për Tatim në Pronë në Prishtinë F.K., dhe sipas këtij raporti nuk kanë gjetur dëshmi relevante që ndërlidhen me rastin.

Bazuar në raportin e ekspertizës numër 191-FVTI-2016 (prova D#8, 8.1 dhe 8.2) dy CD, rezulton se janë gjetur programe (software). Këto dy CD, përmbajnë programe për udhëzime se si të rivendosen fjalëkalimet e humbura të programeve të administratorit të domenit, zhbllokime të llogarive si administrator, programe për resetim të fjalëkalimeve, thyerje të fjalëkalimeve e programe tjera përmes të cilave mundësohet ndërhyrja e paautorizuar në llogaritë e përdoruesve tjerë.

Nga raporti i Ekspertizës se Agjensionit Kosovar për Forenzikë numër AKF-2016-0095, rezulton se është bërë ekzaminimi i shtëpizës së kompjuterit të markës “HP”, me numër serik CZC4463WXY, i konfiskuar nga F.K., zyrtar në departamentin e tatimit në pronë në Prishtinë, nga i cili raport nuk rezulton ndonjë provë relevante lidhur me rastin.

Nga lista e obliguesve tatimor që u janë shlyer borxhet dhe nga kartelat financiare, rezulton se borxhet për tatim në pronë i janë shlyer A., A. dhe R.K., V.M., N.B., J.K., E.A., dhe V.B., e që është në përputhje të plotë me ekspertizën financiar të kryer nga eksperti U.S..

Nga evidencat e hyrje daljeve të zyrtareve në objektet e Komunës së Pejës, për vitin 2016 për tre persona (dëshmia në CD 1), rezulton se në periudha të caktuara kohore, në kohën kur ka pasur aktivitet programi Keylogger, M.L. dhe G.T. në të shumtën e rasteve nuk kanë qenë në zyrë, ndërsa H. K. ka qenë. Gjithashtu nga shtëpiza e G.T. janë regjistruar aktivitete edhe me data 25.09.2016 ora 20:56:32, me 26.09.2016 ora 20:55:56, me datë 03.10.2016 dhe 07.10.2016 e regjistruar si drive removable Sokol. Fakti se aktivitetet përmes removable disk nuk kanë regjistruar në rubrikën e parë kohën e regjistruar në shtëpizë, por vetëm kohën e aktivitetit apo qasjen e fundit, dëshmojnë se nga i akuzuari jo vetëm që ka pasur ndërhyrje edhe pas sekustrimit të kompjuterit të tij por i njëjti ka pasur qasje edhe nga distanca në këtë shtëpizë. Aktiviteti i fundit nga kjo shtëpizë është me datë 13.10.2019 ora 11:39:33.

Nga raporti nga Departamenti i Tatimit në Pronë për Komunën e Pejës për pagesat e tatimit në pronë për vitin 2014, 2015 dhe 2016, rezulton se për faturën e tatimit në pronë nr. 31728056 borxhi është 129.45€, i ndarë në dy këste për vitin 2017, kurse borxhi për vitet paraprake është 0.00. Në dëshminë e pranuar nga Komuna e Pejës, formati zyrtar (faturat e tatimit në pronë dhe kartelat financiare për vitin 2017), rezulton se fatura e tatimit në pronë nr. 31729465, borxhi është 165.24, i ndarë në dy këste për vitin 2017, kurse borxhi për vitet paraprake është 0.00. Regjistrimi manual në sistemin “Protax” për këtë obligues tatimor është me datë 22.04.2016,

kurse në të dhënat e nxjerra në dëshminë e ekzaminuar nga kompjuteri i zyrtares M., rezulton se e njëjta me datë 22.04.2016, fare nuk ka pasur qasje në llogarinë e saj në Protax.

Bazuar në dëshmitë e siguruara nga Komuna e Pejës, rezulton se personi V.M., posedon dy prona me numër 8312094152 dhe nr. 8312093477, sipas regjistrimeve të Bankës Qendrore, dëshmohet se në vitin 2016, me datë 13.06.2016, është bërë vetëm një pagesë në emër të kësaj prone me numër 8312094152, dhe atë në shumë prej 9.50€. Për pronën me numër 8312093477, poashtu në emër të V.M., është bërë vetëm një pagesë 38.86€, poashtu me datë 13.06.2016. Bazuar në dëshmitë e siguruara nga Komuna e Pejës, rezulton se fatura e tatimit në pronë për pronën nr. 8312094152 për vitin 2017 është 93.50€, kurse borxhi nga vitet paraprake 0.00. Poashtu për pronën me numër 8312093477 fatura e tatimit në pronë është 61.37€, kurse borxhi nga vitet paraprake 2.12.

Nga raporti i Raiffeisen Bank rezulton se në xhirollogarinë e të akuzuarit nga viti 2001 e gjerë ne vitin 2015 ka pasur të regjistruara deponime para të gatshme prej 20 gjerë në 500 € në shumë të përgjithshme 12.440.69 € të cilat shuma i ka tërhequr kohë pas kohën dhe në kohën e sigurimit të këtij raporti gjendja ka qenë 00.

Nga raporti i ProCredit Bank ne xhirollogarinë e të akuzuarit rezulton që sipas të dhënave nga viti 2005 e gjerë me datë 02.11.2016 shuma e përgjithshme e qarkullimit është 44.154.80 €, kurse bilanci i gjendjes është 470.13€, në këtë xhirollogari i akuzuari ka pranuar pagën nga Buxheti i Kosovës.

Nga raport i TEB bankës për xhirollogarinë e këtu të akuzuarit H. K., nuk ka rezultuar asnjë transaksion.

Nga raporti i kompanisë “Vala” për thirrjet hyrëse dhe dalëse, dhe raporti i kompanisë “Ipko” për thirrjet hyrëse dhe dalëse, nuk është siguruar ndonjë dëshmi relevante lidhur me rastin.

Nga raporti i ekspertizës financiare të punuar nga eksperti U.S., i datës 12.04.2018, rezulton se pas zbulimit të ndërhyrjeve të palejuara përmes programit Protax, në periudhën nga data 14.07.2016 e deri me datë 18.10.2016, është dëmtuar Komuna e Pejës, në shumë prej 18,275.98€. Ndërsa gjendja e dëmit të shkaktuar, mbështetur në kartela financiare për këtë periudhë është shuma prej 18.557.64 €, ku diferenca është 281.86€. Obliguesit me numër të pronës 3172765 si është pasqyruar në tabelën në faqen 10 të ekspertizës nën numrin rendor 5, i është rikthyer gjendja ashtu si ishte para ndërhyrjeve.

Nga përgjigjja e dhënë nga Ministria e Financave-Departamenti i Tatimit në Pronë, e lëshuar sipas kërkesës së kësaj gjykate të datës 06.05.2019, rezulton se nga Zv. Menaxheri i projektit për Zhvillim të TI-së, E.M., janë dhënë disa përgjigje lidhur me programin Protax. Sipas të njëjtit programi Protax është program informativ i cili përdoret për të administruar tatimin në pronë në Republikën e Kosovës. Protax është sistem i aplikacion ueb (ang. Web Application), i centralizuar, zhvillohet, mirëmbahet dhe operohet nga Ministria e Financave dhe përdoret nga Komunitat e Kosovës dhe qytetaret nëpërmjet e-Shërbimit. Ky sistem përdoret nga: 1.

Departamenti i Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave 2. Zyre Komunale të Tatimit në Pronë 3. Qytetaret të cilët mund të shtypin faturën online nëpërmjet shërbimit E-fatura. Sistemi informative është i qasshëm nga rrjeti qeveritar si dhe nga rrjeti i Internetit që i bie që është i qasshëm nga jashtë institucionet shtetërore. Zyrat komunale të tatimit në pronë nuk janë të pajisura me linkun e qasjes nga jashtë, zyrtarët komunal janë të njoftuar vetëm me linkun e qasjes nga brenda rrjetit qeveritar. Poashtu, për qasje nga jashtë duhet të ofrohet username dhe password i njëjtë me atë që përdoret nga brenda rrjetit. Qasja nga jashtë aplikohet për aplikacionin për anketim në teren të cilin e përdorin Anketuesit e Zyrave Komunale të Tatimit në Pronë. Linku nuk është i dukshëm as për anketuesit meqenëse linku është i koduar (i përfshirë) në aplikacionin që ata e përdorin për anketim. Poashtu shërbimi E-fatura është i qasshëm për publikun, nëpërmjet internetit. Ky shërbim mundëson shtypjen e faturës online dhe asgjë me tepër. Nëse qasen nga jashtë në modulën Protax1, nëpërmjet username dhe password valid, dhe nëse përdoruesi ka privilegje administrative në sistem për të bërë ndryshime atëherë mund të bëhen ndryshimet edhe nga jashtë. Ndërsa qasja në modulën E-fatura është e hapur dhe ofron vetëm mundësinë e shtypjes së faturës.

Termi Protax 2 përdoret për të emëruar dy gjëra të ndryshme, Projektin Protax 2 dhe Sistemin Informativ Projekti Protax 2 ka filluar në maj të vitit 2014, dhe është paraparë të zgjate deri në fund të vitit 2020. Ky projekt i financuar nga SIDA Suedeze dhe i implementuar nga Agjencioni Suedez i Taksave zhvillohet në Departamentin e Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave. Ndërsa Sistemi Informativ Protax 2 është Ueb Aplikacion që përdoret për vlerësimin masiv të objekteve dhe tokave. Ky sistem është zhvilluar duke filluar nga viti 2014 dhe ka filluar të përdoret nga viti 2016 për vlerësimin masiv të Tokave. Sistemi Protax1 përdoret për të administruar Regjistrimin, tatimin dhe vjeljen e tatimit në pronë, ndërsa Protax2 përdoret për vlerësimin masiv të tokave dhe objekteve. Protax1 dhe Protax2 kanë secili linkun e vet, që dallojnë nga njeri tjetri. Linku për Protax1 është: <https://protax.mf-rks.org/protax/> linku për Protax2 është: <https://protax.mf-rks.org/protax2/>. Protax1 e ka edhe linkun për qasje nga jashtë rrjetit qeveritar, që është: <https://pts.mf-rks.org/protax/>. Kësaj përgjigje i ka bashkangjitur dhe historinë e ngjarjeve për përdoruesin M.L. për periudhën janar-tetor 2016.

Nga raporti i Drejtorisë së Teknikës Kriminallistike (në tekstin e mëtejme referuar “DTK”), Sektori për Fotografi, Video analizë dhe Ekzaminimin të TI-së Njësia për Ekzaminimin e Pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit 156/191-FVTI-2019, të datës 27.05.2019, rezulton se sipas urdhëresës së gjykatës, ekspertet A.K. dhe Shqipe Salihu TI, janë dhënë të gjeturat dhe përfundimet sipas të cilës është thënë se Free Keylogger, është program i cili ruan çdo të dhënë që shtypet në tastierën e përdoruesit të kompjuterit, veçanërisht përdoret për të marrë informata konfidenciale (password dhe username). Instalimi i tij mund të bëhet duke pasur qasje direkt në kompjuter apo duke iu qasur nga distanca (qase Remote). Pas instalimit, fsheh vetveten (nuk vërehet që është i instaluar) dhe gjithashtu krijon raporte për të dhënat e futura përmes tastierës. Kjo është edhe pjesa kryesore që e bënë këtë program (keylogger) të rëndësishëm. Programi Free Keylogger Pro starton në të njëjtën kohë me startimin e sistemit operativ Windows. Është i padukshëm, nuk shihet ikona e tij gjatë punës në kompjuter përderisa ai ekzekutohet në prapavijë. Të dhënat e futura përmes tastierës i ruan në formë të raporteve në tekst fajlla përmbajtja e të cilëve organizohet në rreshta duke i ndarë me datë dhe kohë klikimet përmes tastierës.



Deinstalimi i tij mund të bëhet në mënyrë automatike ashtu siç është konfiguruar në fillim, p.sh nëse sot e kemi instaluar këtë keylogger dhe dëshirojmë që ai të deinstalohet nga kompjuter me datë të caktuar, mjafton që në konfigurim të përcaktohet data dhe të aktivizohet opsioni i tillë. Në Kosovë nuk ekziston një rregullore që standardizon në mënyrë specifike përdorimin e programeve në institucionet publike. Legjislacioni ynë rregullon përgjegjësinë e Administratorëve lokal dhe qendror të sistemeve nga fusha e Teknologjisë së Informacionit. Administratorët e sistemit të TI-së, përcaktojnë se cilët programe janë të nevojshme dhe të lejuara të përdoren në një sistem të cilin ata e menaxhojnë.

CCleaner është program për kompjuterët që punojnë në sistemin operativ Microsoft Windows. Instalimi i programit kërkon që llogaria e përdoruesit të Sistemit Operativ-Windows-IT, të jetë Administrator apo cilido përdorues (ang. User) tjetër me të drejtat e Administratori që ka qasje në kompjuter. Instalimi bëhet nga “Setup-i”, i programit dhe është me ndërfaqe-dritare (Graphical User Interface) ku kërkohet miratimi i përdoruesit me “Next, Agree etj”. Ky program përdoret për:

- Pastrimin e diskut të kompjuterit nga fajllat, mbetjet e fajllave të panevojshëm, regjistrat e sistemit operativ-Windows apo aktiviteteve tjera varësisht prej konfigurimit apo përdoruesi i tij;
- Fshin gjurmët e dokumenteve që janë përdorur apo që janë fshirë nga përdoruesi;
- Pastron historinë e shfletuesve dhe fajllat e përkohshëm të internetit çdo herë që mbyllet Internet Explorer, Chrome apo shfletues të tjerë. Mbron privatësinë në kompjuter duke fshirë fjalëkalimet dhe fajllat e tjerë të përkohshëm të Internetit, në mënyrë që askush të mos jetë në gjendje të shoh se çfarë keni vizituar;
- Mbron privatësinë nga shumë aplikacione të sistemit operativ-Windows, duke fshirë informacionin rreth dosjeve që keni përdorur;
- Deinstalon programet edhe kur paneli i kontrollit të sistemit operativ-Windows “Add/Remove Programs” nuk ju lejon;
- Menaxhon fajllat “cookies” në kompjuter ashtu që pamundëson faqet e internetit të përdorin për të gjurmuar vizitat e tuaja;
- Kontrollon dhe pastron kompjuterin rregullisht dhe automatikisht varësisht nga konfigurimi.

Nga komunitetit i Forenzikës së kompjuterëve gjerësisht pranohet se ky program është antiforenzjik.

PravySoft Keylogger është program i krijuar për qëllim studimore, jo për keqpërdorim. Me anë të këtij programi mund të ruhen kredencialet e shfrytëzuesit (username dhe password) gjatë punës në kompjuter. Për instalimin e programit nuk kërkohen procedurat Next Agree, etj. Për aktivizimin e tij mjafton që të klikohet në fjallin ekzekutiv “PravySoft keylogger.exe”. Kur programi është aktiv ruhen të gjitha të dhënat që shtypen me tastierë. Të dhënat të cilat shtypen në tastierë ruhen në tekste fjalë me emrin “pravyssoft.txt”. Ky fajll gjenerohet automatikisht pas ekzekutimit të programit dhe ruhet në të njëjtin vend (shteg-path) ku gjendet programi, pra pa

pasur nevojë të instalohet, vetëm të ekzekutohet. Pas 100 klikimeve në tastierë paraqitet paralajmërimi i këtij programi, të cilin përdoruesi i kompjuteri nëse është i vëmendshëm mund ta sheh.

Shfletuesi i internetit TOR (The Onion Router), është program pa pagesë i cili ndihmon për të mbrojtur anonimitetin e përdoruesit gjatë përdorimit të internetit (fsheh IP Adresën e përdoruesit. Tor-i përbehet nga dy pjesë, softueri që mund të shkarkohet dhe që ju lejon të përdorni internetin në mënyrë anonime dhe rrjetin vullnetar të kompjuterëve (TOR nodes), që bën të mundur që ky program të funksionojë. Tor-i trafikun e internetit e enkripton dhe e drejton përmes më shumë se 7000 njejeve (relay) vullnetare, gjë që e mundëson fshehjen e vendndodhjes dhe aktivitetin e përdoruesit. Përdorimi i Tor-it, e bënë me të vështirë gjurmimin e aktivitetit të internetit tek përdoruesi dhe kjo përfshinë: shfletimin e faqeve të internetit, hapjen e email-ave, rrjetet sociale ose komunikimet dhe shumë aktivitete tjera. Qëllimi i përdorimit të TOR-it, është të ruaj privatësinë personale të përdoruesve për të kryer komunikime konfidenciale.

Tor nuk kufizon qasje në internet, pra nuk pengon ndonjë shërbim online dhe përdorimi i tij është thuajse i ngjashëm me shfletuesit e tjerë të internetit. TOR mbron privatësinë e përdoruesit por nuk mund të fshihet fakti nëse është përdorë. Instalimi i TOR-it, mund të bëhet nga “setup” i tij, apo mund të ekzekutohet nga fajllat e ekstraktuar pa pasur nevojë të instalohet. Team Viewer është program i cili mundëson qasje në distancë prej një kompjuteri në një kompjuter tjetër të cilët gjenden në të njëjtën rrjetë apo përmes internetit. Për të pasur qasje nga një kompjuter në një kompjuter tjetër përmes programit Team Viewer, programi duhet të jetë i instaluar në të dy kompjuterët. Pas instalimit të programit në të dy kompjuterët, për qasje duhet të jetë i instaluar në të dy kompjuterët. Pas instalimit të programit në të dy kompjuterët, për qasje nga kompjuteri A në kompjuterin B nevojitet Numri Identifikues (ID) dhe Fjalëkalimi (password) të cilët shfaqen në mënyrë automatike pas startimit të programit. Nëse kompjuteri A dëshiron të lidhet në kompjuterin B, duhet të ketë Numrin Identifikues (ID) dhe Fjalëkalimi (password) e kompjuterit B.

Prova E#1 (në raportin 156-FVTI-2016 shënohet si D#1), prova e shënuar si E#1, nuk është ekzaminuar. Nuk ka pasur kapacitete harduerike brenda njësisë së kësaj drejtorie për procesimin e kësaj prove.

Për provën E#2 (Në raportin 156-FVTI-2016 është shënuar si D#2).

a) Programi Free Keylogger, në provën E#2, janë gjetë fajlla të programit Free Keylogger Pro. Të gjithë fajllat janë të fshirë “Delete”. Të dhënat si emri i fajllit, shtegu (path), data e krijimit, data e modifikimit, data e qasjes, vlerat HASH për MD5 dhe SHA1, si dhe statusi i fajllit (Y nënkupton që fajlli është i fshirë, N nënkupton që fajlli është fshirë) janë të listuar me poshtë. Të gjithë këta fajlla janë pjesë të raportit elektronik 156-FVTI-2019, në shtegun E\_Raport. Në gjendjen aktuale të kompjuterit (kohën kur është ekzaminuar) ky program nuk figuron si i instaluar.

Fajlli me numër rendor 8, 11, 30 është i njëjtë. Rëndësi për sqarim të përmbajtjes paraqet pikërisht ky fajll i cili është i emëruar si Free Keylogger Pro 7\_21\_2016.klg.txt. ky fajll përmban aktivitete të regjistruar nga përdoruesi M..L.. Bazuar në të dhënat nga vula kohore e fjallit, ky fajll është i kopjuar në provën E#2.

b) Programi CCleaner, në provën E#2 programi është në listën e programeve të instaluar. Programi ka qenë aktiv për përdoruesit Administrator, H..K., kk-pe189. Këto të dhëna janë pjesë nga raporti për regjistrat e kompjuterit (referencë raportit 156-FVTI-2016 shtegu R\_Raportit/D2\_Registry Report.html). Programi nuk regjistron aktivitetin e këtij programi. Rrjedhimisht nuk mund të sqarohet aktivitetin që është bërë me këtë program.

c) Programi Pravysoft-Në provën E#2, është gjetur folderi me emrin PravySoft keylogger dhe fajlli PravySoft keylogger.exe. Folder-i dhe fajlli janë fshirë “Delete”. Rikthimi i tyre është bërë nga hapësira e paalokuar, e diskut (ang.unallocates space). Nuk është arritur të gjendet ndonjë e dhënë që tregon për aktivitetin e këtij programi. Kopja elektronike e fajllave është në raportin elektronik 156-FVTI-2016 shtegu E\_Report/Export/keylogger/DiskImage/D/Lost Files/desk/PravySoft keylogger. Të dhënat si emri i fjallit, shtegu (path) elektronik 156-FVTI-2016 shtegu E\_Report/Export/keylogger/Disk Image/D/Lost Files/des/PravSoft keylogger. Të dhënat si emri i fjallit, shtegu (path), data e krijimit, data e modifikimit, data e qasjes, vlerat HASH për MD5 dhe SHA1 si dhe statusi i fjallit (Y nënkupton që fajlli është i fshirë N nënkupton që fajlli nuk është i shirë) janë të listuara më poshtë. (Referencë, raporti elektronik 156-FVTI-2016/E\_Raport/RaportD2.pdf faqe 3, 8, 12).

d) Programi TorBrowser- Në provën E#2 në volumin D: në shtegun D:/New folder/New folder/Tor Browser/ është program (setup) i plotë dhe ekzekutiv. Aktiviteti i këtij programi nuk mund të lexohet (historia e aktivitetit është e enkriptuar). Nga komuniteti i Forenzikës së kompjuterëve gjerësisht pranohet se ky program është antiforenzik. Programi (kopja elektronike) është pjesë e raportit 156-FVTI-2016, i vendosur në shtegun E\_Raport/Export/TorBrowser/E/New folder/Tor Browser. Të dhënat siemri, shtegu, datat për folderat dhe fajllat janë pjesë e raportit E\_Raport/raporti D2.pdf faqe 13 deri 210).

e) Programi Team Viewer- Në provën E#2 janë gjetur katër folder-a të fshirë me emrin Team Viwer. Folderat janë të zbrazët-pa fajlla. Nuk është arrit të gjendet ndonjë fajll që tregon për aktivitetin e këtij programi.

Kopja elektronike e folder-ave është pjesë e raportit 156-FVTI-2016, i vendosur në shtegun E\_Raport/Export/TeamViewer.

Të dhënat për folder-at si emri, shtegu, datat janë të listuara si më poshtë (referencë, raporti E\_Raport/RaportiD2.pdf. faqe 11).

f.1 Kërkimi bazuar në fjalën kyçe “Protax”- në lidhje me programin Protax, janë ndërtuar filtra duke përdorur fjalën kyçe “Protax”. Si rezultat kanë arritur të rikthejnë fajllat që përmbajnë fjalën

“Protax”. Kopja elektronike e fajllave është pjesë e raportit 156-FVTI-2016. Shtegu i fajllave E\_Raport/Export/Protax/D/Lost Files.<sup>9</sup>

<sup>9</sup> 39) *linku.txt*

Name linku.txt  
True Path 156-FVTI-2016\Disk Image\D\Lost Files\desk\linku.txt  
Last Accessed 21/09/16 15:38:46 (+2:00 Central European Daylight Time)  
File Created 21/09/16 15:38:46 (+2:00 Central European Daylight Time)  
Last Written 18/01/13 11:16:34 (+1:00 Central European Standard Time)  
MD5 e07291dddefeb726528ae8de6fa83f29  
SHA1 6e11172e3b8f3b92072a 2db04cca 47a 874a8ff99  
Is Deleted Y

40) *Free KeyLogger Pro\_7\_21\_2016.klg.txt*

Name Free Keylogger Pro\_7\_21\_2016.klg.txt  
True Path 156-FVTI-2016\Disk Image\D\Lost Files\Key-1\ Free  
Keylogger Pro\_7\_21\_2016.klg.txt  
Last Accessed 21/09/16 15:39:17 (+2:00 Central European Daylight Time)  
File Created 21/09/16 15:39:17 (+2:00 Central European Daylight Time)  
Last Written 22/07/16 12:01:10 (+2:00 Central European Daylight Time)  
MD5 50de3246c7bcf5f2c6083024d 25071d4  
SHA1 a41d3cd01f5cb2314a 6414a edbe77a afla 6cb72e  
Is Deleted Y

41) *New Microsoft Office Word Document.docx*

Name New Microsoft Office Word Document.docx  
True Path 156-FVTI-2016\Disk Image\D\Lost Files\ New Microsoft Office Word  
Document.docx  
Last Accessed 21/09/16 15:45:44 (+2:00 Central European Daylight Time)  
File Created 21/09/16 15:45:44 ( +2:00 Central European Daylight Time)  
Last Written 01/12/14 12:48:44 (+1:00 Central European Standard Time)  
MD5 b9b9857ab3cdd3e5bd33a 5fb2c83e5dd  
SHA1 c2ef166140b7708af20d 55594d794d8333c65194  
Deleted Y

42) *New Microsoft Office Word Document.docx*

Name New Microsoft Office Word Document  
True Path 156-FVTI-2016\Disk Image\D\Lost Files\Key-1 New Microsoft  
Office Word Document.docx  
Last Accessed 21/09/16 15:39:17 (+2:00 Central European Daylight Time)  
File Created Last Written 09/03/16 08:24:16 (+1:00 Central European Standard  
Time)  
Last Written 09/03/16 08:24:16 (+1:00 Central European Standard Time)  
MD5 af622247ae54858f90ddcd 4ff547c500  
SHA1 cf3230a938a 7e5b5c611dd14e9aaaf69aea3a5b5  
Is Deleted Y

43) *GARAIT.TTF*

Name GARAIT.TTF  
True Path 156-FVTI-2016\Disk Image\D\Recovered  
Folders\.\Windows\Fonts\GARAIT.TTF  
Last Accessed 12/07/16 15:42:51 (+2:00 Central European Daylight Time)  
File Created 02/04/04 12:05:30 (+2:00 Central European Daylight Time)

f.1.1 rëndësi për sqarim të përmbajtjes paraqet fajlli me emër Free Keylogger Pro\_7\_21\_2016.klg.txt në shtegun E\_Raport/Export/Protax/D/Lost Files/Key-1. Pjesa e fajllit e cila përmban fjalën “Protax” është kjo.

Kjo nënkupton se fajlli Free Keylogger Pro\_7\_21\_2016.klg.txt përmban aktivitet të përdoruesit “user” Makirjete.L. në web platformën “Protax”. Dritaret e hapura përmes shfletuesit “Google Chrome” kanë titullin:

- Protax-Login dhe
- Protax-Departamenti i Tatimit në Pronë v4.4.0.17
- 

Kurse të dhënat e fatura përmes njësive hyrëse të kompjuterit (tastiera) janë:

- Mmertiamaki
- Be28831be<<<<<<<<<<<<bebe<<<
- 188915093693.20141REGJISTRIM I RI NR LENDES  
620/201611703211789VLLADIMIR
- MERITAMAKIMERITAMAKI  
Meritamaki
- 91890096057

f.1.2 fjalli linku.txt në shtegun E\_Raport/Export/Protax/D/Lost Files/desk. Përmbajtja e fajllit është url link adresë për programin Protax.

f.1.3 Fajlli New Microsoft Office Word Document.docx në shtegu E\_Raport/Export/Protax/D/Lost Files/. Përmbajtja e fajllit është url link adresë për programin Protax.

f.1.4 Fajll New Microsoft Office Word Document.docx në shtegun E\_Raport/Export/Protax/D/Lost/Files/Key-1. Përmbajtja e fajllit është url link adresë për programin Protax.

f.3 Qasja në nëpërmjet rrjetës

f.3.1 Nga rezultatet e analizuara me programin IEF version 6.8.1.2634, në mënyrë tabelare (tabela 1) paraqesim gjurmët (ang. Log) e vizituar nëpërmjet rrjetit kompjuterik nga prova E#2 në drejtim të kompjuterit iu cili ka si përdorues M..L..

---

Last Written	02/04/04 12:05:30 (+1.00 Central European Daylight Time)
MD5	0fefb7e909e 7774d69611e540644d7f8
SHA1	697319fce 2b3a0e3416c7650802f95437e65364b
Is Deleted	Y

Këto të dhëna janë pjesë e raportit elektronik 156-FVTI-2016/1/HTML Export 2016-10-10\_11-31-05/index.html tek menyja Internet Explorer Main History.

Interpretimi i rreshtit të parë me numër 1061 (interpretimi është i njëjtë për të gjithë rreshtat e tabelës).

1061 <file://10.153.68.148/cs/User/M..L./Desktop/shkronjat.doc> H. K. 07/20/2016  
06:35:52AM

Me datë 20 korrik 2016 ora 08:35:52 AM (UTC+2) nga përdoruesi H..K. nëpërmjet rrjetit kompjuterik është vizituar fajlli shkronjat.doc. i cili gjendet në shtegun c\$/Users/M..L./Desktop/shkronjat.doc në kompjuterin e identifikuar me IP adresë //10.153.68.148 dhe me përdorues M..L..

Vëmendje:

Vula kohore (timestamp) 07/20/2016 ka konfigurim muaji/dita/viti, ndërsa ora, shembull 06:35:52 AM është UTC 0. Ora referente për regjionin tonë për këtë periudhë kohore të vitit është UTC +2. Të dhënave nga Tabela 1 që kanë të bëjnë me orën (Time-(UTC)) duhet shtuar +2 orë për të paraqitur për kohën lokale.

F.3.2 Nga rezultatet e nxjerra me programin Encase v8.05.00.182 rezulton se nga prova E#2 nëpërmjet rrjetit kompjuterik nga përdoruesi (user) H..K., Administrator dhe kk-pe189 ka pas qasje në kompjuter të ndryshëm. Lista e plotë në Anexi\_1-Tablea3.

Në mënyrë tabelare-Tabela2 paraqiten gjurmët (ang.loh) e vizitave nëpërmjet rrjetit kompjuterik, nga prova E#2, nëpërmjet përdoruesit (user) H..K., Administrator dhe kk-pe-189 në drejtim të kompjuterëve të cilët identifikohen me përdoruesin M..L. dhe G.T..

- Nga prova E#2, përdoruesi H..K. ka pas qasje në kompjuterin që identifikohet me përdoruesin M..L..<sup>10</sup>
- Nga prova E#2, përdoruesi Administrator ka pas qasje në kompjuterin që identifikohet me përdoruesin M..L. (referojuni ekspertizës në fjalë, përkatësisht rreshtave 88-118, 131-144, 152-165, 193-210, 153-267).
- Nga prova E#2, përdoruesi Administrator ka pas qasje në kompjuterin që identifikohet me përdoruesin G.T. (referojuni rreshtave në tabele 120-126).

### 3. Për provën E#3 (Në raportin 191-FVTI-2016 shënohet si D#1)

a) FreeKeylogger Pro-Aktiviteti i gjetur në provën E#3 që ka të bëjë me programin Free Keylogger Pro është se janë gjetur gjurmë të qasjes në katër tekst fajlla, emërimi i të cilëve ka të bëjë me programin Free Keylogger Pro. Bazuar në shtegun e qasjes së këtyre fajllave, këta

<sup>10</sup> Shih raportin e Drejtorisë së Teknikës Kriminologjike të datës 27.05.2019, faqe 26 nga 68.

fajlla janë hapur me këtë provë nga particioni C:/ prej useri M..L. e të cilat nuk janë gjetur fizikisht në këtë provë.<sup>11</sup>

#### *Instalimi dhe deinstalimi i programit Free Keylogger Pro*

Programi Free Keylogger Pro nuk figuron të jetë instaluar në listën e programeve të instaluar në këtë kompjuter, megjithatë ka gjurmë që ka të bëjë me instalimin dhe deinstalimin e këtij programi.

*Instalimi me datë 05 shtator 2016 dhe deinstalimi me datë 06 shtator 2016.*

b) PravySoft në këtë provë është gjetur gjurmë që ka të bëjë me hapjen e një tekst fajlli emërtii i të cilit ka të bëjë me program.

c) Ccleaner, Tor Browser, Team Viwer

Nga programet Ccleaner, TorBrowser, Team Viwer nuk është gjetur ndonjë gjurmë.

#### *4. Për provën E#4 (Në raportin 191-FVTI-2016 shënohet si D#2).*

a) Free Keylogger Pro-Në provën E#4 gjurmët e gjetura që kanë të bëjë me programin FreeKeylogger Pro qasja në një tekst fajlli emërimi i të cilit ka të bëjë me programin FreeKeylogger Pro. Bazuar në shtegun e hapjes së këtij fajlli, ky fajll është hapur nga një USB Drive.<sup>12</sup>

Emri i këtij tekst fajlli i cili është hapur në këtë provë përmes USB Drive me datë 06.09.2016 ora 12:04:29 është i njëjtë për nga emri me atë i cili është hapur në dëshminë E#3 me datë 06.09.2016 ora 11:53:46.

Aktiviteti tjetër në lidhje me këtë program është hapja e një zip fajlli me emër *fk-logger.zip* nga USB me datë 04 mars 2016 nga Useri GT-ZKK.

b)Pravysoft- Nga programi “Pravysoft” është gjetur gjurmë që ka të bëjë me qasje në një tekst fajll emërtimi i të cilit ka të bëjë me këtë program *pravysoft.txt*.

c) Ccleaner- programi “CCleaner” që njihet edhe si program antiforenzik në këtë provë ky prgram rezulton të jetë i instaluar në listën e programeve të instaluara.

Në këtë provë aktivitet të programit CCleaner ka pasur me datë 24.08.2016.

d) Tor Browser dhe Team Viewer

<sup>11</sup> Shih faqen 37 nga 68 të ekspertizës së DTK(Drejtoria e Teknikës Kriminallistike) të datës 27.05.2019.

<sup>12</sup> Shih faqen 39 nga 68 të ekspertizës në fjalë.

Nga programet TorBrowser dhe Team Viewer nuk është gjetur ndonjë gjurmë.

e) Të dhënat tjera me rëndësi.

NetScan- Program tjetër me rëndësi është dhe programi Net Scan i cili skenon rrjetën dhe liston IP adresat e kompjuterëve që gjenden në atë rrjetë.

Me datë 13.10.2016, bazuar në shtegun e logut të mëposhtëm në USB Drive F:/ është bërë qasje në fajllin netscan.zip. përveç se iu është qasur këtij zip fajlli, të dhënat tjera në lidhje me këtë program nuk janë gjetur, p.sh për të kuptuar se për cilin program-skanues të rrjetit është fjala, versionin e tij, etj.<sup>13</sup>

Qasja në Userin M..L. përmes rrjetës- Me datë 01.03.2016 është gjetur gjurmë se nga prova E#4 përmes rrjetit kompjuterik ka pasur qasje në userin M..L..

Bazuar në këtë log, me datë 01 mars 2016 Useri GT-ZKKK është qasur në userin M..L. përmes IP Adresë 10.153.68.135 dhe është hapur një fotografi në follderin /Picture/Foto/ sc-peja/Gjakove/përvjetori-2014/Përvjetori i SC Gjakova 2015.jpg.

Qasja tjetër në rrjetë nga kjo provë ka edhe në data tjera përmes userave: G.T. dhe Administrator.

Qasja në Protax-janë gjetur dy linqe që kanë të bëjnë me qasjen në Protax

Linku.txt-E dhënë tjetër me rëndësi është hapja e fajllit linku.txt. përmes USB-ve.

USB-ja me emër SOKOL e cila është konektuar në këtë kompjuter me data të ndryshme, me numër serik 9431-12DO dhe nga e cila është hapur fajlli “linku.tx”, ka qenë e konektuar gjithashtu edhe në provën E#5. Nga prova E#5 gjithashtu është hapur fajlli “linku.txt” përmes USB-e.

##### *5. Për provën E#5 (Në raportin 191-FVTI-2016 shënohet si D#3)*

Emri i userit në këtë provë është “SOKOL”

a) FreeKeylogger Pro- Në provën E#5, ky program nuk figuron të jetë i instaluar. I gjithë aktiviteti që ka të bëjë me këtë program është listuar më poshtë. Bazuar në shtegun e llogave shihet që fajllat ekzekutiv janë hapur nga USB-e dhe nga kompjuteri.<sup>14</sup>

b) Pravysoft- Prrogrami “Pravysoft” në këtë provë është gjetur si program ekzekutiv. Ky program është i fshirë dhe është kthyer nga pjesa e paaluokuar e diskut.

<sup>13</sup> Shih ekspertizën e DTK, faqe 40 nga 68.

<sup>14</sup> Shih ekspertizën e DTK faqe 43 nga 68. Ku është pasqyruar aktiviteti USB.



c) CCleaner-programi “Ccleaner” në këtë kompjuter rezulton të jetë i instaluar.

Me datë 08 tetor 2016 në ora 12:51:54 ka pasur aktivitet lidhur me këtë program.

d) TorBrowser-shfletuesi i internetit “TorBrowser” në këtë provë është gjetur si fajlli ekzekutiv i vendosur në disa folldera (lokacione).

e) Team Viwer

Nga programi Team Viewer nuk është gjetur ndonjë gjurmë.

f) Të dhënat tjera me rëndësi në lidhje me provën E#5  
NetScan-në këtë provë është gjetur se përmes USB është hapur fajlli *netscan.zip*.

Fajlli “New Microsoft Office Word Document.doc”- E dhënë tjetër me rëndësi është përmbajtja e këtij fajlli që lidhet me “Protax” i cili në këtë kompjuter është krijuar me datë 27 shtator 2016 ora 18:26:05.

*Përmbajtja e fajllit*

[http://10.41.0.74:59074/prothttp://10.41.0.74:59074/protax/login.jsp?logoutCompletedax/login.jsp?login\\_error](http://10.41.0.74:59074/prothttp://10.41.0.74:59074/protax/login.jsp?logoutCompletedax/login.jsp?login_error).

**Vërejtje: IP Adresa 10.41.0.74 dhe numri i portit 59074 është i njëjtë me atë në provën E#4 që ka të bëjë me qasje në protax.**

**Fajlli “linku.txt”-USB e cila është kyçur në këtë provë dhe nga e cila është hapur fajlli linku.txt, rezulton të jetë e njëjtë me USB, e cila është kyçur në provën E#4.**

*6. Për provën E#6 (Në raportin 191-FVTI-2016 shënohet si D#4)*

a) Team Viewer- Nga programi Team Viewer është gjetur një link (shourcut) fajll, nga i cili shihet se është deinstaluar programi Team Viewer me datë 15 nëntor 2011. Ky link fajll është i fshirë dhe është kthyer nga pjesa e pa alokuar e diskut.

Të dhëna tjera me rëndësi në lidhje me provën E#6

Fajlli “instalimi nga best computer.txt”- Përmbajtja e këto fajlli ka të bëjë me instalimin e programit MyLanViwer, program i cili përdoret për skanimin e rrjetës për të listuar IP Adresat e kompjuterëve që janë të lidhura në atë rrjetë.

Në provën E#7, E#8, E#9, nuk janë gjetur gjurmë të kanë të bëjnë me programet: FreeKeylogger Pro, CCleaner, Pravysoft, TorBrowser apo Team Viewer.

10-Për provën E#10 ( Në raportin 191-FVTI-2016 shënohet si D#8)

Prova e shënuar si E#10 janë tri CD të cilat përmbajnë programe me emra: D8\D#8.1\Log.www.centralddl.com\Log.Pass\Delete xp vista login pass\delete xp vista login password works perfectly delete xp vista login password works perfectly\delete xp vista login password y.iso \D8\D#8.1\PWK8\Passware Windows Key Enterprise Edition 8.3.2867 Bootable CD\Demo\winkeyd.exe.

Bazuar në emrat e këtyre fajllave këto programe nuk kanë të bëjnë me programet: Free Keylogger Pro, Ccleaner, Pravysoft, TorBrowser apo Team Viewer.

Nga Akt – emërimi me nr. të kontratës II-112-9771, rezulton se i akuzuari, ka qenë i punësuar në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, me titull të punës Zyrtar i Lartë për të Drejtat e Komuniteteve dhe Integrim, e nënshkruar me datën 04.01.2012.

Nga Formulari-PDP Përshkrimin të detyrave të punës, i lëshuar nga Komuna e Pejës, lidhur me pozitën Zyrtar i Lartë për të Drejtat e Komuniteteve dhe Integrim, sipas të cilit formular, janë të përshkruara detyrat e punës lidhur me këtë pozitë, mirëpo asnjë nga këto detyra e të cekura në këtë formular, nuk kanë të bëjnë me detyra që rrjedhin nga drejtoria e tatimit në pronë.

Vlerësimi i provave dhe ndërlidhja e tyre në raport me veprimet e të akuzuarit

Gjykata pas administrimit të provave në seancën e shqyrtimit kryesor, e në kuptim të nenit 363 par.3 të KPP-së, duke i vlerësuar me ndërgjegje çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, e në bazë të vlerësimit të tillë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nuk ishte kontestuese se i akuzuari H. K., ka punuar në Komunën e Pejës, në cilësi të zyrtarit në Departamentin për Komunitete dhe Kthim.

Nuk ishte kontestues fakti se në Departamentin për Tatim në Pronë, në Komunën e Pejës, kishte ndryshim të obligimeve tatimore në sistemin “Protax”.

Kontestuese deri në fund të shqyrtimit gjyqësor, mbeti rrethana nëse i akuzuari kishte ndërhyrë në ndryshim të obligimeve tatimor, përmes përdoruesit të zyrtares për tatim në pronë M.L. , si dhe nëse këto veprime më pas i përmbajnë elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar.

Gjykata duke vlerësuar konstatimet e bëra nga eksperti i TI A.K., dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 16.09.2021, në raport me dhënien e mendimit në ekspertizën e DTK, sa i përket ekzaminimit të dëshmimeve të riemëruar në raportin e DTK të datës 27.05.2016, si: E#1, E#2, E#3, E#4, E#5, E#6, E#6, E#7, E#8, E#9, E#10, ka gjetur se mendimi i tij është profesional dhe objektiv, të cilat u sqaruan më në detaje në shqyrtim gjyqësor lidhur me paqartësitë që kishte gjykata në raport me këto dëshmi.

Në veçanti ai sqaroi se prova E#2, me përdorues H..K., Administrator dhe kk-pe189, ka pasur qasje në drejtim të kompjuterëve përdorues të të cilëve kanë qenë M..L. dhe G.T..

Ai ka sqaruar tabelën e shfaqur në ekspertizën e DTK, të datës 27.05.2016, faqe 31, ku ka thënë se IP adresa me numër 10.153.68.148 me përdorues H..K., ka pasur qasje në kompjuterin tjetër me IP adrese 10.153.68.148 në volumnin c), nën përdoruesin M. L., në fjallin Protax-Login)files me datë 21.07.2016 ora 11:27:45.

Sa i përket programit Free Keylogger, ai tha se ky program regjistron të gjitha të dhënat që futen përmes njësisë hyrëse tastierës, pra në raste kur në kompjuter shënohet passwordi, në të nuk shfaqen shkronjat apo simbole tjera, por shfaqen “xxx” ndërsa tek kompjuteri tjetër që ka qasje në këtë kompjuter përmes këtij programi, këto “xxx” dalin shkronja, numra, varësisht çfarë shkruani.

Në vlerësim të deklaratës së dëshmitares M.L. dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 22.10.2021, kjo gjykatë vërtetoi se e njëjta gjatë muajit qershor, korrik dhe gusht, për një periudhë të caktuar kohore ishte në pushim vjetor dhe se gjatë kësaj kohe kompjuteri i saj ishte i kyçur. Ajo po ashtu vërtetoi se nuk ka qenë askush në dijeni për username dhe passwordin e saj për qasje në programin Protax, dhe se programin “Free Keylogger”, nuk e ka instaluar asnjëherë në kompjuterin e saj. Gjykatë dëshmisë së kësaj dëshmitare i fali besimin, meqenëse një deklaram i tillë gjen mbështetje dhe në provat materiale, veçanërisht në ekspertizën e DTK, sipas të cilës në periudha të ndryshme janë regjistruar aktivitete në drejtim të kompjuterit të saj, përkatësisht programin Protax.

Nga dëshmia e dëshmitarit G.T., kjo gjykatë vërtetoi se i njëjti ka qenë në të njëjtën zyre me të akuzuarin K., dhe se ky i fundit kishte qenë në dijeni për passwordin e kompjuterit të tij, pasi që kohë pas kohe i akuzuari K., ka shfrytëzuar kompjuterin e tij, si dhe se i njëjti (akuzuari) ka ushtruar detyrat e zyrtarit për kthim dhe komunitete. Deklaratës së këtij dëshmitari gjykata i fali besimin, e njëjta gjen mbështetje dhe në mbrojtjen e të akuzuarit të dhënë në shqyrtimet tjera gjyqësore, pasi që në këtë të fundit është mbrojtur në heshtje.

Sa i përket deklaratës së dëshmitarit J.A., i cili me pozitë ishte drejtor në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, kjo gjykatë vërtetoi se i njëjti pasi kishte vërejtur ndryshme në programin e tatimit në pronë, në kohën kur nuk mund të bëheshin ndryshime, e ka njoftuar kryetarin e komunës, dhe rastin e ka paraqitur në polici. Gjykatë dëshmisë së këtij dëshmitari i fali besimin, meqenëse një deklaram i tillë gjen mbështetje dhe në provat materiale, përkatësisht në kërkesën për fillim të hetimeve e parashtruar në polici me datë 26.08.2016.

Në vlerësim të deklaratave të dëshmitarëve, F.M., A.K., B.G., E.A., A.K., E.K. dhe V.B., kjo gjykatë gjeti deklaratat e të njëjtëve janë pjesërisht të besueshme, pas parasysh se të njëjtit pohuan se kanë shlyer obligimet tatimore, ndërsa gjykata bazuar në ekspertizën e ekspertit financiar U.S., vërtetoi të kundërtën.

Sa i përket pjesës së deklaratës së dëshmitarit B.G., i cili ka thënë se ia ka dhënë të akuzuarit K. 180€, për të shlyer obligimet tatimore për vitin 2016, kjo gjykatë erdhi në përfundim se kësaj pjesë të dëshmisë nuk mund t'i fal besimin, meqenëse kjo deklaratë mbeti si e vetme dhe nuk u provuar me asnjë provë tjetër.

I akuzuari në mbrojtjen e tij dhënë në shqyrtim gjyqësor, ka vendosur që të mbrohet në heshtje, pasi që ka thënë se është deklaruar në seancat e mëhershme ku ka dhënë mbrojtjen e tij ashtu që nuk ka asgjë më shumë për të shtuar. Gjykata, pasi që i pandehuri është mbrojtur në heshtje në këtë shqyrtim gjyqësor, e pasi që ai ka qëndruar në tërësi pranë deklaratimeve të tij, duke u bazuar në nenin 122 par.3 KPPK-së, ka marrë për bazë deklaratat e mëhershme të të akuzuarit të dhëna në shqyrtim, në të cilat ka thënë se që nga data 28.12.2015 është transferuar në Departamentin për Komunitete dhe Kthim në kuadër të Komunës së Pejës, dhe se në këtë zyre ka qenë se bashku me dëshmitarin G.T., me të cilin herë pas herë kanë shiquar filma në kompjuterin e këtij të fundit, me USB të djalit të tij Sokol K.. Në vlerësim të kësaj pjesë të mbrojtjes së të akuzuarit kjo gjykatë gjeti se një mbrojtje e tillë nuk ka mbështetje në prova tjera, përkatësisht me deklaratën e dëshmitarit G.T., e në veçanti me ekspertizën e DTK të datës 27.05.2019, sipas të cilës është gjetur se në USB (në emër të djalit të të akuzuarit) prova E#4, janë gjetur gjurmë të programit Free Keylogger Pro, Pravysoft, CCleaner<sup>15</sup>, dhe jo filma ashtu siç pretendon i akuzuari.

Sa i përket pjesës tjetër të mbrojtjes së të akuzuarit, i cili ka mohuar të jetë njohës i mirë i kompjuterit, dhe rrethanës se nuk ka qenë në njohuri për programin Free Keylogger, dhe fjallat ekzekutiv, të hapur nga prova E#5 dhe E#2, kjo gjykatë bazuar në deklarinimin e ekspertit A.K., si dhe ekspertizës së DTK të datës 27.05.2019, vërtetoi të kundërtën, andaj dhe kësaj pjese të mbrojtjes së të akuzuarit kjo gjykatë nuk i fali besimin, meqenëse pikërisht në provën E#2 (shtëpiza e kompjuterit të të akuzuarit), sipas ekspertizës së DTK, është gjetur se kjo provë ka pas qasje në kompjuterin që identifikohet me përdorues M..L. si dhe në përdoruesin G.T..

Përkatësisht, se ishin gjetur gjurmë të programeve të ndryshmeve në shtëpizën dhe laptopin e të akuzuarit, këtë gjykata e vërtetoi nga dëshmia e ekspertit A.K., i cili tha se në provën e emëruar si E#2-shtëpizë kompjuteri “pa emër” (i sekuestruar nga i akuzuari H. K.) janë gjetur gjurmë të programeve Pravysoft, Team Viewer, kredencialet e përdorueses M..L., se bashku me fjalëkalim, programet CCleaner dhe TorBrowser, si dhe fajlli në New Microsoft Office Word Document.docx, për adresën e programit Protax. Gjurmë të programeve Free Keylogger, Pravysoft, CCleaner dhe TorBrowser janë gjetur dhe në provën si E#5-Laptop “HP” (i sekuestruar nga i akuzuari H. K.).

Qasja me përdoruesin e zyrtares për tatim në pronë M.L. , për ndryshim të obligimeve tatimore ishte bërë pasi ishte kompromentuar siguria e kompjuterit të të njëjtës, përmes programit Free Keylogger Pro, i cili ishte gjetur në provën E#2 (shtëpiza e të akuzuarit), program ky i cili ruan çdo të dhënë që shtypet në tastierën e përdoruesit të kompjuterit dhe se instalimi i tij mund të bëhet duke pasur qasje direkte në kompjuter, apo duke iu qasur nga distanca (qasje Remote).

<sup>15</sup> Shih ekspertizën e DTK të datës 27.05.2019, faqe 39 nga 68. Gjetjet lidhur me USB Drive, për provën E#4.

Sa i përket pretendimit të mbrojtjes, se ndryshimi i të dhënave tatimore nuk mund të bëhej pasi që zyrtarja M.L. , në kohën kur pretendohet se janë bërë këto ndryshime ka qenë në pushim vjetor dhe se kompjuteri i saj ka qenë i fikur, nuk qëndron, pas parasysh se dëshmitarja M.L. , pohoj se gjatë kësaj kohe e ka pasur të kyçur kompjuterin e saj, e mbështetur dhe në deklaratën e ekspertit A.K., i cili tha se kompjuteri konsiderohet se është aktiv dhe mund të kesh qasje ende pa u hap me fjalëkalim (pa u shfaqur ikonat), dhe se programi Free Keylogger, starton se bashku me sistemin operativ “Windows” (menjëherë pas shtypjes së butonit për ndezje).<sup>16</sup>

Gjykata mbështetur në ekspertizën e DTK<sup>17</sup>, vërtetoi se programi Free Keylogger, në provën E#3 (kompjuteri i M.L. ), nuk ishte në listën e programeve të instaluar, edhe pse ishin gjetur gjurmë të këtij programi. Ky program ishte instaluar me datë 05 shtator 2016 dhe ishte deinstaluar me datë 06 shtator 2016, që konsiston me fajllin e njëjtë të gjetur në kompjuterin e të akuzuarit e riemëruar si prova E#2.<sup>18</sup>

Se i akuzuari ka përdorur programe të ndryshme, për qasje dhe ndryshim të të dhënave tatimore, gjykata këtë e vërtetoi dhe me ekspertizën numër 191-FVTI-2016 që ka të bëjë me ekzaminimin e laptopit “HP” të të akuzuarit, sipas të cilit raport ka rezultuar se ka pasur aktivitete për software dhe dokumente në lidhje me Komunën e Pejës, përkatësisht 1010 dokumente brenda pajisjes që ndërlidhen me prokurim, kontrata, dosje të tenderit, njoftime për dhënie të kontratës, vendime të vlerësimit dhe shkresa tjera gjithsej 3217 dokumente që përfshinë periudhën 2012 dhe 2013, kohë kjo kur i akuzuari ka punuar në zyrën e prokurimit.

Gjykata bazuar në ekspertizën e DTK, vërtetoi se në USB e regjistruar me emrin Sokol, të cilën i akuzuari ka pohuar që ka qenë e djalit të tij Sokol K., ishte i ruajtur linku i programit “Protax”, dhe se qasja në këtë program përmes linkut, si dhe username me password mund të bëhej edhe nga jashtë deri në vitin 2021, rrethanë kjo e vërtetuar nga dëshmitari E.M., i cili me pozitë ishte zv. Menaxher i projektit për zhvillim të TI, në kuadër të Ministrisë së Financave.

Se e ka pasur në posedim këtë USB, i akuzuari H. K., këtë e ka pohuar në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimet paraprake gjyqësore, i cili tha se herë pas herë e ka përdorur për të shiquar filma dhe ndeshje sportive, në kompjuterin e kolegut të tij G.T., me arsyetimi se në atë kohë nuk ka pasur kompjuter në zyre.

Bazuar në raportin e ekspertizës së DTK, gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka përdorur dhe kompjuterin e kolegut të tij G.T., për të cilin ky i fundit ka thënë se i akuzuari K. ka qenë në

---

<sup>16</sup> Shih deklaratën e ekspertit Ardian Krasniqi, dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë 16.09.2021, faqe 10 nga 13.

<sup>17</sup> Instalimi dhe deinstalimi i programit Free Keylogger Pro

Programi Free Keylogger Pro nuk figuron të jetë instaluar në listën e programeve të instaluar në këtë kompjuter(E#3), megjithatë ka gjurmë që ka të bëjë me instalimin dhe deinstalimin e këtij programi.

*Instalimi me datë 05 shtator 2016 dhe deinstalimi me datë 06 shtator 2016.*

<sup>18</sup> Shih ekspertizën e DTK në faqe 15, 16 dhe 17 nga 68.

dijeni për passwordin. Sipas këtij raport është vërtetuar në provë E#4 (shtëpiza e kompjuterit “Pentium 4 Dual Core” e dëshmitarit G.T.), janë gjetur gjurmë të programit FreeKeylogger Pro dhe bazuar në shtegun e hapjes së këtij fajlli, ky fajll është hapur nga një USB Drive (me emrin Sokol-djali i të akuzuarit K.). Këto rrethana janë vërtetuar edhe me raportin e ekspertizës 191-FVTI-2016, ku janë paraqitur gjetjet lidhur me ekzaminimin e shtëpizës së dëshmitarit Toska, sipas të cilës me datë 25.09.2016 dhe 26.09.2016, janë regjistruar aktivitete si drive removable Sokol.

Emri i këtij tekst fajlli i cili është hapur në këtë provë përmes USB Drive me datë 06.09.2016 ora 12:04:29 është i njëjtë për nga emri me atë i cili është hapur në dëshminë E#3 (shtëpiza e kompjuterit të dëshmitares L.) me datë 06.09.2016 ora 11:53:46.

USB-ja me emër Sokol e cila është konjektuar në këtë kompjuter me data të ndryshme, me numër serik 9431-12DO dhe nga e cila është hapur fajlli “linku.tx”, ka qenë e konjektuar gjithashtu edhe në provën E#5. Nga prova E#5 gjithashtu është hapur fajlli “linku.txt” përmes USB.

Sa i përket pretendimit të mbrojtësit se ka qenë e pamundshme ndërhyrja në obligime tatimore nga i akuzuari K., meqenëse në kohën kur supozohen se janë ndërmarrë këto veprime, i njëjti nuk ka pasur kompjuter, nuk qëndron, kjo për faktin se gjykata nga deklarata e dëshmitarit G.T., dhe mbrojtja e të akuzuarit, vërtetoj të kundërtën, sepse i akuzuari në atë periudhë kishte shfrytëzuar kompjuterin e këtij të fundit, rrethanë e pa mohuar edhe nga vet i akuzuari në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimet e mëhershme gjyqësore.

Se e ka pasur linkun e Protaxit, ai këtë e vërtetoj edhe në vetë në mbrojtjen e tij, i cili tha këtë link e ka pasur të ruajtur me kërkesën e drejtorit të Drejtorit për Buxhet dhe Financa, Musaj Rexhaj.

### Vlerësimi juridik

Vepra penale *Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së*, për të cilën është akuzuar H. K., përbëhet nga elementet objektive e që janë veprimi dhe pasoja (Actus Reus) ashtu si dhe nga qëllimi kriminal (Mens rea) lidhur me secilin element të veprës penale. Për të ekzistuar një vepër penale, këto elemente duhet të përmbushen në mënyrë kumulative. Vepra penale në fjalë, si e tillë, mund të kryhet me veprim dhe vetëm me dashje direkte të kryesit. Kur jemi tek dashja, e njëjta duhet të paraqitet si në veprim e poashtu edhe në pasojë, sidomos tek vepra penale që është objekt shqyrtimi, pasi që forma të tjera të fajtit, tek kjo vepër nuk mund të vijnë në shprehje.

Veprimi kriminal i të akuzuarit e po ashtu edhe pasoja, që të dyja këto elemente objektive janë plotësuar, sepse nga elbaorimi i mësipërm i provave materiale e po ashtu edhe atyre personale, e që janë dëshmitë e dëshmitarëve, është vërtetuar se i akuzuar ka ndërmarrë veprime e të cilat edhe kanë shkaktuar pasojën e pretenduar, mirëpo çështja tani është se këto veprime të tij, a lidhen me qëllimin kriminal të cilin e ka pasur i akuzuari, respektivisht nëse qëllimi i tij kriminal të ketë qenë të kryhet vepra penale për të cilën edhe është akuzuar, pra e domosdoshme është që

të ketë ekzistuar relacioni psiqik (mendor) i të akuzuarit me veprën e tij dhe pasojat e asaj vepre. Pavarësisht kësaj, gjykata tërheq vëmendjen se vepra penale *keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së*, si objekt mbrojtës të saj e ka detyrën zyrtare, e cila hynë në kategorinë e veprave penale të njohura si *delicta propria*, e të cilat mund të kryhen vetëm nga një kategori e caktuar e personave. Konkretisht, këto vepra penale mund t'i kryejnë personat të cilët janë bartës të këtyre autorizimeve zyrtare, apo personat që kanë kompetenca për të kryer autorizimet zyrtare të caktuara.

Vepra penale në fjalë, përkatësisht veprimet për të cilët është ngarkuar i akuzuari K., ka të bëjë me tejkalimin e kompetencave të tij, në kuadër të detyrës së tij zyrtare. Pra, në mënyrë që të konsumohet kjo vepër penale, kryesi i saj, duhet që veprimet të cilat i ka ndërmarra t'i ketë në kuadrin e detyrave të tij, të lidhura me vendin e tij të punës, e që më pastaj, me veprimet e tij, të bëjë tejkalimin e kompetencave të tij, e që në rastin konkret i akuzuari K. bazuar në formularin e përshkrimit të detyrave të punës, të lëshuar nga Komuna e Pejës, *rezulton se detyrat e tij fare nuk kanë të bëjnë me detyrat përgjegjësitë e një zyrtari në departamentin për tatim në pronë*.

Prokuroria pretendon se i akuzuari nga data 14.07.2016 e në vazhdimësi gjerë me datën 18.10.2016, me qëllim që t'i shkaktoj dëm personit tjetër dhe atë Komunës së Pejës, si person zyrtar, duke shfrytëzuar detyrën zyrtare, i tejkalon kompetencat e tij, të përcaktuara në akt emërimin nr. 01-112-169 në formularin-PDP, në atë mënyrë që, pasi i akuzuari kishte qenë i punësuar në Komunën e Pejës si zyrtar për tatim, e më pas në Drejtorinë për buxhet dhe financa nga e cila ishte suspenduar, për tu *transferuar* përkohësisht në vendin e punës zyrtar i lartë për të drejtat e komuniteteve dhe integrim në kuadër të Komunës së Pejës duke filluar nga data 28.12.2015 e gjerë me datën 28.12.2016, me qëllim të shkakimit të dëmit Komunës së Pejës, nga data 14.07.2016 e deri me datën 18.10.2016, duke qenë i pajisur me linkun e sistemit *Protax* si ish zyrtar i tatimit në pronë, të shkarkuar në USB, pasi i akuzuari kishte të instaluar programin *Free Keylogger Pro* në kompjuterin e tij zyrtar me numër serik KPjKKP1-382, të G.T. dhe M.L. arrin që kësaj t'ia marrë password dhe username të sistemit *Protax* të M.s dhe përmes shfletuesit "GoogleChrome" dhe "InternetExplorer" futet në programin *ProTax – Login* dhe *ProTax – Departamenti i Tatimit në Pronë* tek përdoruesi M.L., gjersa përmes programit *Tor Browser* fsheh IP adresën e tij dhe aktivitetin si përdorues, fillimisht shfrytëzon kompjuterin e zyrtarit G.T., i cili ka qenë në të njëjtën zyre me të dhe duke shfrytëzuar kompjuterin e tij zyrtar dhe laptopin e tij personal, përmes të cilëve hynë në sistemin *Protax* dhe nga përdoruesi M.L., pa u bërë pagesat, shlyen obligimet tatimore të dëshmitarëve J.K., E.A., A.K., N.B., V.M., R.K., A.K. dhe V.B., ashtu që Komunës së Pejës i shkakton dëm në shumën prej 18,275.98€, e më pas përmes programit *CCleaner* fshinë historinë e fajllave të shfletuar.

Mirëpo, bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, është gjetur se i akuzuari në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i punësuar në Komunën e Pejës, në Departamentin për Komunitet dhe Kthim, *pra si person zyrtar në kuadër të detyrave të tij, nuk ka pas të bëjë me Departamentin për Tatim dhe Pronë*, andaj dhe nuk mund t'i inkorporohet veprimi inkriminues se si person zyrtar në Komunën e Pejës-Departamenti për Komunitet dhe Kthim, ka shfrytëzuar pozitën e tij zyrtare, duke tejkaluar kompetencat e tij me qëllim përfitimit të kundërligjshëm.

Në përshkrim faktik të veprës penale më tej është thënë se ai më parë kishte qenë i pajisur me linkun e programit Protax si ish zyrtar i tatimit në pronë të shkarkuar në USB. Pra nga vet përshkrimi faktik i veprës penale vërehet qartë se i akuzuari ishte **ish zyrtar i departamentit për tatim dhe pronë**, ai thjesht ka pas në posedim linkun e Protaxit, me të cilin ka pasur mundësi të qaset nga jashtë, e që në rastin konkret ai ka shfrytëzuar këtë link, siç është shpjeguar dhe më lartë dhe përmes përdoruesit dhe fjalëkalimit të M.L. ka ndërhyrë në obligime tatimore.

Pavarësisht faktit se gjykata ka gjetur se i akuzuari ka ndërhyrë në sistemin Protax, të cilin e ka pasur në posedim e në të cilin është çasur përmes përdoruesit dhe fjalëkalimit të M.L. , gjykata të njëjtin e liroj nga aktakuza, sepse duke u bazuar në nenin 359 par.1 të KPPK-së, gjykata është e lidhur për veprën e cila është objekt i akuzës së paraqitur ose asaj të ndryshuar apo zgjeruar.

Në këtë kuptim, gjykata nuk mundet të bëjë tejkalime të aktakuzës siç janë dhënë dhe vërejtjet nga Gjykata e Apelit, në aspektin objektiv apo subjektiv, sepse gjykata duhet të vërtetojë nëse veprimet e të akuzuarit, a i përgjigjen veprës penale për të cilën është akuzuar dhe nuk mundet që veprimeve të akuzuarit t'ia përshtat ndonjë veprë tjetër penale, sepse më pastaj detyrohet që të bëjë ndryshime në veprimet e të akuzuarit duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, e më pas dhe në një vepër tjetër penal, ku si rrjedhojë e kësaj, do të bëhej tejkalimi i akuzës në aspektin subjektiv dhe objekti.

Fakti se gjykata nuk është e lidhur me kualifikimin ligjor të veprës, të propozuar nga prokurori i shtetit, të paraparë me nenin 359 par.2 të KPPK-së, gjykata konsideron se një gjë e tillë, mund të vije në shprehje vetëm në situata të veprave penale të kategorisë së njëjtë, e me të cilën nuk rëndohet situata e të akuzuarit. Me këtë rast, gjykata ka parasysh parimet mbi të cilat është e ndërtuar procedura penale, në të cilin roli i gjykatës është pasiv, dhe barra e të provuarit lidhur me ekzistimin apo jo të një veprë penale, i bie prokurorisë së shtetit, pasi që e njëjta është bartëse e akuzës dhe zhvillon hetime për veprat penale për të cilat konsideron që kanë dyshim të bazuar mirë, e që më pas mund të marrin një epilog në favor të akuzës.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarës në kontest të rregullt juridiko-civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, u morr konform nenit 462 par.3 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, është marrë në bazë të nenit 453 par.1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 360 dhe 363 par. 1.3 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.238/22**

**Bashkëpunëtore profesionale**  
Elzana Kastrati

**Kryetarja e trupit gjykues**  
Nushe Kuka Mekaj



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmjet kësaj Gjykate.